



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 220

Tiranë – E mërkurë, 26 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Page
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 5.11.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025”, të ndryshuar..... 27751
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 26, datë 17.11.2025	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të konkurrimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe përditësimit të teksteve shkollore dhe përmbajtjeve digjitale, si dhe miratimit të katalogut zyrtar të teksteve shkollore në sistemin arsimor parauniversitar..... 27751
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 190, datë 21.11.2025	Për delegim kompetence..... 27763
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 9.10.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, për sa i përket çështjes nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë regjistrimi 13.3.2019, në lidhje me vendimin nr. 4868, datë 6.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 42, datë 21.1.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura. Konstatimin e statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si rrjedhojë e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin <i>Scordino kundër Italisë</i> . Rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të vendimit “Për plotësimin e të metave të kërkesës”, datë 30.4.2024, të Gjykatës së Lartë dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim..... 27763

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 16.10.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 2399/2516, datë 30.5.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-3568, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	27772
Vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2025-4083 (79), datë 18.2.2025	Me objekt detyrimin e familjes bujqësore, me përfaqësues Nazmi Beqiri, të paguajë vlerën monetare për pasurinë e shitur prej 2600 m ² , në shumën 1.164.800 lekë.	27782
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Katerina Papa.....	27791



VENDIM

Nr. 644, datë 5.11.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 110, DATË 19.2.2025,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT
DHE TË MESME DREJTUESE EDHE
PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2025”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, të vendimit nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 23, të kreut I, shtohet pika 24, me këtë përmbajtje:

“24. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit të Pronës Shtetërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.”;

b) Në kreun II bëhen këto ndryshime:

i. pika 27 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”;

ii. pika 33 shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

UDHËZIM

Nr. 26, datë 17.11.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT,
VLERËSIMIT, PËRZGJEDHJES DHE
PËRDITËSIMIT TË TEKSTEVE
SHKOLLORE DHE PËRMBAJTJEVE
DIGJITALE, SI DHE MIRATIMIT TË
KATALOGUT ZYRTAR TË TEKSTEVE
SHKOLLORE NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47, të ligjit 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar; si dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, të ministrit të Arsimit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Tekstet shkollore dhe përmbajtjet digjitale të tyre sigurohen nga botuesit, vendës ose të huaj, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të barabartë dhe transparent, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Hartimi i teksteve shkollore të reja dhe i përmbajtjeve digjitale të tyre bëhet në përputhje me programet mësimore përkatëse dhe në respektim të standardeve të teksteve shkollore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Përditësimi i tekstit shkollor të nxënësit është procesi i ripunimit të përmbajtjes për tekstet shkollore, të cilët janë pjesë e katalogut të teksteve shkollore, miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

4. Përditësimi i tekstit shkollor të nxënësit bëhet në rastet kur programi lëndor, në kuadër të ndryshimeve të Kornizës Kurrikulare, ndryshon deri në masën 30%.



5. Përditësimi i tekstit shkollor të nxënësit për çdo lëndë të secilës klasë bëhet nga botuesit.

6. Procedurat për përditësimin dhe miratimin e teksteve shkollore të përditësuara realizohen dhe administrohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

7. Përmbajtja digjitale është paraqitja e tekstit shkollor të nxënësit në format elektronik, që mund të lexohet, dëgjohet, shihet dhe ndërveprohet nëpërmjet pajisjeve teknologjike (kompjuter, tablet, *smartboard* etj.).

8. Përmbajtja digjitale e teksteve shkollore është në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe me tekstin shkollor përkatës, si dhe me kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim.

9. Përmbajtja digjitale e teksteve shkollore kërkohet dhe vlerësohet vetëm për tri alternativat fituese, pas shpalljes së renditjes paraprake të teksteve të reja shkollore.

10. Shtëpitë botuese të tri alternativave që janë shpallur paraprakisht fituese të teksteve shkollore, duhet të sjellin, brenda një afati të përcaktuar, me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, përmbajtjen digjitale që shoqëron tekstin fitues përkatës.

11. Kërkesat për konkurrim për tekste të reja shkollore dhe përmbajtje digjitale të tyre, si dhe afatet e procedurave të konkurrimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

12. Lista fituese e teksteve shkollore dhe përmbajtjeve digjitale të tyre që do të përdoren nga nxënësit, përmban deri në tri alternativa për çdo lëndë të secilës klasë.

13. Botuesit vendës të teksteve shkollore dhe shpërndarësit e teksteve shkollore të gjuhëve të huaja të botuesve të huaj, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim për tekstet e reja shkollore vetëm me një alternativë për çdo lëndë të secilës klasë.

14. Katalogu Zyrtar i Teksteve Shkollore është lista përfundimtare e teksteve të miratuara për përdorim në sistemin arsimor parauniversitar. Katalogu përmban të gjitha tekstet e miratuara sipas klasave dhe lëndëve përkatëse dhe përditësohet pas çdo procesi vlerësimi ose përditësimi të teksteve shkollore. Katalogu miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin dhe publikohet çdo vit përpara fillimit të vitit të ri shkollor.

15. Shpenzimet e konkurrimit përballohen nga subjektet konkurruese.

KREU II

PËRMBAJTJA DIGJITALE E TEKSTIT SHKOLLOR TË NXËNËSIT

Përmbajtja digjitale e tekstit shkollor të nxënësit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të integrojë funksionet bazë të mësimdhënies dhe nxënies përmes ndërveprimit aktiv dhe aktiviteteve ndërvepruese;

b) Të përdoret si në mësimin në klasë, ashtu edhe në distancë, në mënyrë individuale ose në grup;

c) Të funksionojë plotësisht me pajisjet digjitale që përdorin institucionet arsimore (p.sh., në *Smart Lab*);

ç) Të jetë e aksesueshme pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së tekstit shkollor;

d) Të jetë e lehtë për t'u përdorur nga të gjithë nxënësit dhe mësuesit;

dh) Të ketë akses dhe përdorim të sigurt të nxënësve dhe mësuesve;

e) Të mundësojë përditësimin teknik dhe përmbajtjesor pa penguar përdorimin e saj;

ë) Të jetë e pavarur nga pajisja ose sistemi operativ;

f) Të jetë e ripërdorshme dhe e përshtatshme për kontekste të tjera mësimore;

g) Të paraqitet në formatin elektronik në ministrinë përgjegjëse për arsimin;

gj) Të përmbajë elemente multimediale (video, audio, animacione, simulime etj.) që mbështesin mësimdhënien;

h) Materialet të jenë të organizuara në mënyrë të qartë sipas kapitujve/temave dhe të përmbajnë:

i. përshkrimin e tematikave, mësimëve dhe aktiviteteve;

ii. ushtrime, simulime, teste, vetëvlerësime;

iii. udhëzues për përdorimin pedagogjik dhe teknik nga mësuesit.

KREU III

PËRDITËSIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Procesi i përditësimit të teksteve shkollore realizohet nga ASCAP-ja, menjëherë pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin të programeve mësimore të përditësuara.



2. ASCAP-ja harton dhe miraton Kornizën e Përditësimit të Teksteve (KPT), e cila përcakton procedurat, udhëzimet dhe kriteret për organizimin e procesit të përditësimit të teksteve shkollore, duke garantuar përputhshmëri me dokumentet kurrikulare të përditësuara.

3. ASCAP-ja, pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin të programeve mësimore të përditësuara, njofton shtëpitë botuese për fillimin e procesit të përditësimit të teksteve shkollore, si dhe harton treguesit e përditësimit të teksteve shkollore sipas lëndëve dhe klasave përkatëse.

4. Shtëpitë botuese dorëzojnë në ASCAP tekstet shkollore të përditësuara brenda një afati prej 3 (tre) muajsh nga data e marrjes së njoftimit zyrtar nga ASCAP-ja.

5. ASCAP, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga dorëzimi i teksteve të përditësuara, kryen procesin e vlerësimit, sipas procedurave të brendshme të miratuara prej tij dhe përgatit listën paraprake të teksteve të përditësuara.

6. Një kopje e tekstit të përditësuar, së bashku me të gjitha materialet përkatëse të procesit të përditësimit, protokollohet dhe arkivohet në ASCAP.

7. ASCAP-ja përgatit dhe dërgon në ministrinë përgjegjëse për arsimin listën e teksteve shkollore të përditësuara dhe listën e teksteve shkollore që botuesi nuk i ka përditësuar sipas kriterëve të vendosura në KPT.

8. Ministria përgjegjëse për arsimin heq nga Katalogu Zyrtar i Teksteve Shkollore, tekstet shkollore që ASCAP-ja i ka dërguar si tekste të pa përditësuara nga botuesi dhe njofton botuesin.

KREU IV KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Për menaxhimin e procesit të konkurrimit për tekstet shkollore të reja dhe përmbajtjet digjitale ngrihet dhe funksionon Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore, në vijim “Komisioni”, si dhe Sekretaria Teknike e tij në vijim “Sekretaria”.

2. Përbërja e komisionit dhe sekretarisë caktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

3. Parimet e funksionimit të komisionit janë ligjshmëria, paanësia, objektiviteti, konfidencialiteti dhe transparenca.

4. Anëtari i komisionit dhe i sekretarisë nuk mund të jetë autor në tekstet shkollore, botues apo pronar shtypshkronje.

5. Vendimet e komisionit, bazohen në procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluara, zbardhen dhe konsiderohen akte administrative.

6. Funksionimi i komisionit:

a) Ngrihet dhe funksionon sipas kuadrit ligjor për organet kolegjiale;

b) Harton dhe miraton rregulloren e brendshme të tij;

c) Kryetari i komisionit organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit, ndan detyrat për anëtarët që përfaqësojnë komisionin në marrëdhënie me palët e treta dhe nënshkruan vendimet e komisionit;

ç) Vendimet e komisionit merren me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve;

d) Procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje;

dh) Harton katalogun e teksteve shkollore të reja dhe përmbajtjeve digjitale të tyre që do të përdoren nga nxënësit dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për arsimin;

e) Shpall katalogun e teksteve shkollore pas miratimit nga ministri përgjegjës për arsimin.

7. Komisioni ka për detyrë:

a) Të verifikojë përputhshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar për konkurrim për tekstet e reja shkollore, me dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi;

b) Të caktojë vlerësuesit e teksteve shkollore të reja dhe vlerësuesit për përmbajtjet digjitale, sipas kriterëve të vendosura në këtë udhëzim;

c) Të trajnojnë vlerësuesit e teksteve shkollore të reja dhe vlerësuesit e përmbajtjeve digjitale;

ç) Të organizojë punën për procesin e vlerësimit të teksteve shkollore të reja dhe përmbajtjeve digjitale, duke ruajtur anonimatën, si dhe ta mbikëqyr këtë proces;

d) Të analizojë dhe të përpunojë rezultatet e vlerësimit të teksteve shkollore të reja dhe përmbajtjeve digjitale të bërë nga vlerësuesit, për çdo lëndë të secilës klasë;

dh) Të nxjerrë vlerën mesatare të standardeve për secilin tekst shkollor të ri dhe përmbajtje digjitale për çdo lëndë të secilës klasë, mbi bazën e vlerësimeve të vlerësuesve;

e) Të rendisë, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, tekstet shkollore të reja për çdo lëndë dhe klasë, sipas pikëve të marra nga secili tekst;



ë) Të shpallë renditjen paraprake të teksteve të reja shkollore;

f) Të shqyrtojë ankesat për procesin e konkurrimit për tekste të reja shkollore dhe përmbajtje digjitale, si dhe të përgatisë kthimin e përgjigjeve.

g) Të shpallë, pas përfundimit të afatit të ankesave, renditjen përfundimtare të teksteve shkollore të reja dhe të përmbajtjeve digjitale për lëndë dhe klasë, sipas pikëve.

8. Detyrat e sekretarisë dhe detyra të tjera të komisionit përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të komisionit.

9. Në rast se për një lëndë mësimore të një klase të caktuar, nuk ka asnjë alternativë fituese, atëherë procedura e konkurrimit rishpallet.

KREU V

DOKUMENTACIONI PËR KONKURRIM

1. Subjektet e interesuara për konkurrim dorëzojnë në sekretarinë e Komisionit të Vlerësimit të Teksteve Shkollore dokumentacionin dhe elementet teknike të mëposhtme:

a) Subjekti konkurrues për të pasur të drejtë të marrë pjesë në konkurrim duhet të paraqesë dokumentet ligjore, si vijon:

i. ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si botues dhe/ose shpërndarës dhe certifikatën e regjistrimit në organet tatimore;

ii. vërtetim nga organet tatimore që subjekti nuk ka detyrime të pashlyera;

iii. vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që subjekti nuk ka detyrime të pashlyera;

iv. vërtetim nga gjykata (dhoma penale, civile dhe administrative), që botuesi dhe/ose shpërndarësi nuk është në proces gjyqësor penal apo në procedura falimentare;

v. vërtetim nga prokuroria që botuesi dhe/ose shpërndarësi nuk është në ndjekje penale.

b) Subjekti konkurrues, për çdo titull teksti shkollor, fut në zarf të bardhë, format A4, të mbyllur dhe të dyllësuar, pa shenja të jashtme dalluese që mund të zbulojnë përkatësinë e zarfit, në origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin, dokumentet teknike si vijon:

i. deklaratën e botuesit për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave,

sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

ii. deklaratën për të drejtën e botimit, mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe të pjesëve të veçanta të saj, si dhe kopje të akteve ose të marrëveshjeve që lidhen me aplikimin për marrjen e lejes ose për blerjen e elementeve të veçanta të së drejtës së autorit nga të tretët, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. E drejta e botimit/përshtatjes duhet të merret detyrimisht edhe për botim të teksteve në gjuhët e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë;

iii. deklaratën për autorësinë e tekstit, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

iv. kontratën/at e lidhur/a ndërmjet botuesit dhe autorit/ëve; e drejta e botimit/e përshtatjes duhet të merret detyrimisht edhe për botim të teksteve në gjuhët e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Pas përgatitjes së tekstit shkollor të miratuar, e drejta e shumëfishimit të tij i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin;

v. deklaratën për çmimin e shitjes me pakicë të tekstit shkollor, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

vi. të dhënat për autorin/ët e tekstit shkollor, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

vii. të dhënat për ekipin realizues të tekstit shkollor, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

c) Subjekti konkurrues për çdo titull teksti shkollor paraqet elementet teknike të teksteve të reja shkollore, si më poshtë:

i. pesë kopje të çdo titulli teksti shkollor të ri që garanton konfidencialitetin e subjektit/të autorëve;

ii. çdo kopje e tekstit të jetë e radhitur, e faqësuar dhe e shtypur me letrën dhe në formatin, siç parashikohet të dalë nga shtypi;

iii. çdo kopje të jetë e lidhur me vrima e me kapëse plastike, me ngjyrë të zezë; të mos ketë kopertinë e *frontespice*; faqet të mos përmbajnë elemente që mundet të identifikojnë përkatësinë e tekstit shkollor;

iv. asnjë prej kopjeve të teksteve të paraqitura për konkurrim të mos përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit që i ka teksti, kur është i gatshëm për përdorim, si: autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese, si dhe të dhëna të tjera që mund të identifikojnë botuesin;



v. në çdo kopje që dorëzohet, titulli i tekstit të shkruhet sipas emërimit të bërë në urdhrin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin; titulli të shkruhet me ngjyrë të zezë, në llojin e letres së bllokut të librit, me shkronja të mëdha shtypi, tip “*Bookman Old Style*”, *bold*, me madhësi 36-she. Në rast moszbatimi të kësaj kërkesë, teksti shkollor nuk pranohet për konkurrim;

vi. numrat rendorë të faqeve të jenë me shkronja të vogla “*Bookman Old Style*”, me madhësi 12-she, me ngjyrë të zezë, jo *bold*, në mesin e çdo faqeje.

ç) Elementet teknike të përmbajtjeve digjitale të teksteve shkollore janë, si më poshtë:

i. të dorëzohet në formate të standardizuara ndërkombëtare si: *HTML5*, *PDF interaktiv*, *SCORM 1.2* ose më i lartë, si dhe formate të njohura të medias, si *MP4/MP3* dhe *PNG/JPEG*, në mënyrë që të sigurohet përdorimi i plotë;

ii. të jetë plotësisht funksionale në *Windows* dhe në pajisje si kompjuterë, *tabletë*, *smartboard* dhe pajisje të laboratorëve *SmartLab*, pa kërkuar instalime shtesë;

iii. videot të jenë me cilësi minimumi *Full HD* (1080p), audio e pastër dhe pa zhurma;

iv. imazhet duhet të kenë rezolucion jo më pak se 1920×1080, të jenë pa *watermark* dhe të pajisura me licenca të vlefshme të përdorimit, në përputhje me standardet e së drejtës së autorit.

2. Dokumentacioni ligjor, dokumentacioni teknik dhe elementet teknike, paraqiten pranë sekretarisë së komisionit, brenda afateve të përcaktuara në urdhrin e ministrit.

3. Dorëzimi i dokumentacionit dhe i materialeve të tjera bëhet nga administratori i subjektit, apo persona të tjerë të autorizuar prej tij me shkrim.

4. Sekretaria e ngarkuar për pranim të dokumentacionit pajis subjektin konkurrues me procesverbal të marrjes në dorëzim të dokumentacionit dhe materialeve të tjera.

5. Dokumentacioni ligjor, teknik dhe materialet e tjera të pranuar për konkurrim, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk i kthehen subjektit konkurrues.

6. Subjekti konkurrues nuk pranohet në konkurrim në rast se nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin ligjor, teknik dhe elementet teknike të teksteve shkollore, të përcaktuara në këtë udhëzim. Ministria përgjegjëse për arsimin njofton subjektin konkurrues për arsyen e mospranimit në konkurrim.

KREU VI

VLERËSIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE DHE PËRMBAJTJEVE DIGJITALE

1. Vlerësimi i tekstit shkollor kryhet bazuar në Standardet e Teksteve Shkollore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, nga pesë vlerësues:

a) një pedagog i lëndës përkatëse;

b) dy mësues të lëndës sipas nivelit arsimor përkatës;

c) një specialist i gjuhës shqipe për standardin “Aspektet gjuhësore”;

ç) një specialist i fushës së botimeve për standardin “Kritere teknike të tekstit shkollor”.

2. Vlerësimi i përmbajtjes digjitale realizohet nga tre vlerësues si më poshtë:

a) 1 (një) mësues i profilit lëndor dhe nivelit përkatës, i cili vlerëson standardin “Përputhshmëria me programin lëndor dhe tekstin shkollor përkatës”, bazuar në Standardet e Teksteve Shkollore të miratuara;

b) 1 (një) mësues i lëndës “TIK” ose specialist i fushës së teknologjisë së informacionit të komunikimit, i cili vlerëson standardin “Kriteret teknike të përmbajtjes digjitale” bazuar në Standardet e Teksteve Shkollore të miratuara;

c) 1 (një) mësues i gjuhës shqipe për të vlerësuar standardin “Aspektet gjuhësore të përmbajtjes digjitale”, sipas Standardeve të Teksteve Shkollore të miratuara.

KREU VII

PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË TEKSTEVE TË REJA

1. Çmimet e teksteve shkollore të reja, të cilat do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga Komisioni, propozohen nga subjektet konkurruese dhe vlerësohen, sipas metodologjisë së mëposhtme:

a) Çmimet e teksteve dorëzohen nga subjektet konkurruese të mbyllura në zarf.

b) Pas përfundimit të afatit të dorëzimit dhe vlerësimit të teksteve, komisioni bën hapjen dhe leximin e çmimeve të propozuara për tekstet nga subjektet konkurruese. Sekretaria harton procesverbalin e hapjes, një kopje të të cilit ua vë në dispozicion subjekteve konkurruese në proces.

c) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe renditjes së teksteve, për tekstet që rezultojnë fituese, Komisioni bën përllogaritjen dhe vlerësimin e



çmimit mesatar aritmetik ose të çmimit tavan të teksteve të miratuara.

ç) Çmimi mesatar aritmetik ose çmimi tavan përlogaritët si shuma e çmimit të teksteve fituese për një tekst të caktuar, pjesëtuar me numrin e teksteve fituese. Ky çmim tavan aplikohet për ato tekste, për të cilat çmimi i propozuar nga subjekti e tejkalon çmimin tavan, ndërsa për tekstet e ofruara me çmim poshtë çmimit tavan, ato do të shiten me çmimin e ofruar nga subjekti.

Shembull: Qytetaria, klasa e parë (*hard copy*)

- Shtëpia botuese X – 500 lekë

- Shtëpia botuese Y – 555 lekë

- Shtëpia botuese Z – 445 lekë

Çmimi tavan = $(500 + 555 + 445) : 3 = 500$ lekë.

Shtëpia botuese Z ruan çmimin 445 lekë; shtëpitë botuese X dhe Y do të aplikojnë çmimin 500 lekë.

2. Nëse çmimi tavan i përlogaritët ose çmimet e propozuara poshtë tij tejkalojnë marzhin e barabartë me normën e inflacionit mbi çmimin tavan të tekstit analog të vitit të mëparshëm, Komisioni kërkon analizë të detajuar të çmimit. Çmimi përfundimtar nuk duhet të tejkalojë këtë kufi.

Shembull: Nëse teksti analog ishte 485 lekë dhe norma e inflacionit 3,5%, çmimi maksimal i pranueshëm është 502 lekë $(485 \times 1,035)$.

3. Përcaktimi i çmimit për tekstet pa analogë dhe tekste me ndryshime në planin mësimor bëhet sipas rregullave, si më poshtë:

a) Për tekstet që hyjnë në qarkullim për herë të parë dhe nuk kanë tekst analog nga viti i mëparshëm, çmimi përcaktohet nga MA vetëm në bazë të mesatares aritmetike, pa kufizim nga inflacioni.

b) Për tekstet që kanë ndryshime në numrin e orëve mësimore, çmimi përcaktohet në bazë të formulës: Çmimi tavan i tekstit analog $\times$ koeficienti i planit mësimor.

Shembull: Çmimi i tekstit analog = 360 lekë; Koeficienti rritës = 1.35; Çmimi tavan i ri = $360 \times 1.35 = 486$ lekë.

4. Nëse në përfundim të procesit të vlerësimit rezultojnë më pak se dy tekste të kualifikuara, çmimi vendoset nga subjekti, por nuk mund të kalojë kufirin maksimal të normës së inflacionit për tekstet e printuara dhe inflacion + 50% për përmbajtjet digjitale.

KREU VIII

ANKIMIMI

1. Çdo palë që ka një interes të ligjshëm lidhur me procesin e konkurimit dhe të përzgjedhjes së teksteve shkollore të reja, ka të drejtën e ankimit të vendimeve të komisionit.

2. Botuesit kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e vendimit nga komisioni.

3. Ankesa paraqitet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit. Ankesat depozitohen me shkrim në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në ankesë të përshkruhet dhe interesi i ligjshëm lidhur me procesin e konkurimit.

4. Shqyrtimi i ankesave bëhet sipas procedurës, si më poshtë:

a) Ankesat të shqyrtohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga komisioni, i cili shprehet me vendim të argumentuar mbi ankesën, duke e pranuar ose rrëzuar atë.

b) Lidhur me vendimmarrjen e komisionit, për ankesat e paraqitura, subjekti ka të drejtën e ankimit te ministri brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e vendimit të komisionit.

c) Ministri përgjegjës për arsimin ose i autorizuari prej tij, shqyrton ankesën dhe merr vendimin brenda 10 (dhjetë) ditëve. Vendimi i marrë është përfundimtar. Kundër vendimit mund të bëhet ankimim në rrugë gjyqësore.

KREU IX

KONFLIKTI I INTERESIT

1. Në procesin e hartimit të teksteve shkollore të reja, punonjësit e ministrisë përgjegjëse për arsimin, punonjësit e institucioneve të varësisë, vlerësuesit dhe anëtarët e komisionit dhe të sekretarisë nuk duhet të jenë autorë teksti shkollor, botues, pronarë shtypshkronje, si dhe duhet të deklarojnë gjendjen e konfliktit të interesit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

2. Çdo anëtar i komisionit dhe i sekretarisë, si dhe çdo vlerësues, para fillimit të punës duhet të plotësojë dhe të nënshkruajë deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për konfliktin e interesit,



respektivisht sipas shtojcave nr. 7 dhe nr. 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

KREU X DETYRIMET E SHTËPIVE BOTUESE

1. Botuesi merr përsipër dhe mban përgjegjësi për marrëdhëniet e tij me autorët e teksteve, për përgatitjen për shtyp të origjinaleve të teksteve.

2. Botuesi, në kapakun e çdo kopjeje të tekstit shkollor, të shënojë të gjitha elementet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për librin.

3. Botuesi, në çdo kopje të tekstit shkollor, të vendosë elementet për hyrjen dhe përdorimin e përmbajtjes digjitale të tekstit shkollor.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokumentacioni ligjor lidhur me procesin e konkurrimit të teksteve shkollore të reja (aktet, programet lëndore, standardet e teksteve shkollore etj.), si dhe çdo material tjetër shpjegues për të interesuarit, publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

2. Anëtarët e komisionit dhe të sekretarisë, si dhe

vlerësuesit paguhen sipas legjislacionit në fuqi për pagesën e anëtarëve, në përbërje të komisioneve për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera ndihmëse, në sistemin arsimor parauniversitar.

3. Udhëzimi nr. 26, datë 11.12.2017, “Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore, Sekretaria Teknike, dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani

SHTOJCA NR. 1: DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Deklaroj se asnjë prej autorëve, vlerësuesve, redaktorëve shkencorë/letrarë dhe përkthyesit/përshtatësit, të përfshirë në shtojcat nr. 3 dhe nr. 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimit, të tekstit shkollor me titull:

_____, dorëzuar për konkurrim në MA, nuk është i lidhur me interesa familjarë ose financiarë me punonjës të MA-së dhe institucioneve të saj të varësisë.

Deklaroj po ashtu, se nënshkruesi i kësaj deklarate nuk është i lidhur me interesa familjarë ose financiarë me punonjës të institucioneve të përmendura më lart.

_____, më _____. _____. 202 ____

PËR BOTUESIN/SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

**SHTOJCA NR. 2: DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT**

Deklaroj se “E drejta e botimit” e tekstit me titull:

_____ ,
dorëzuar për konkurs në MA:

Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____
6. _____	_____	_____

_____, më _____. _____. 202_____

PËR BOTUESIN/SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

Shënim për plotësimin e formularit

Si pjesë të tekstit, për efekt të burimit të së drejtës së botimit, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide, ose punë editoriale. Zotërimi i kësaj të drejte nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse të lidhur mes autorit/ëve dhe botuesit, ose me dokumente të blerjes, apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave i bashkëlidhen kësaj deklaratë. Në rastet kur e drejta e botimit është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e së drejtës së botimit shënohet “Punë origjinale”. Në kolonën e burimit të së drejtës së botimit shënohet, sipas rastit: “Origjinale”, ose “Nga të tretë” (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).

**SHTOJCA NR. 3: DEKLARATA PËR AUTORËSINË E TEKSTIT**

Deklaroj se autori/ët e tekstit me titull:

_____, dorëzuar për konkurs në MA, janë:

Emri, mbiemri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	
6.	
7.	
8.	

_____, më _____. _____. 202____

PËR BOTUESIN/SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

SHTOJCA NR. 4: DEKLARATA PËR ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË TË TEKSTIT

Deklaroj se çmimi i shitjes me pakicë të tekstit me titull _____

_____, dorëzuar për konkurs në MA, është

(_____)
(me shifra) (me shkrim)

lekë.

_____, më _____. _____. 202____

PËR BOTUESIN/SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

**SHTOJCA NR. 5: TË DHËNA PËR AUTORIN/ËT E TEKSTIT SHKOLLOR**

Autorësia	Po	Jo
Autor i vetëm, pedagog	☐	☐
Autor i vetëm, mësues	☐	☐
Dy ose më shumë pedagogë	☐	☐
Dy ose më shumë mësues	☐	☐
Pedagog dhe mësues	☐	☐
Më shumë se dy pedagogë dhe mësues	☐	☐
Arsimi i lartë: (Diploma që zotëron)	☐	☐
Diplomuar brenda vendit	☐	☐
Diplomuar jashtë vendit	☐	☐

Kualifikimi dhe/ose grada shkencore/ titulli akademik:

Kualifikimi/ Grada shkencore/Titulli akademik	Brenda vendit	Jashtë vendit
Master	☐	☐
“Doktor”	☐	☐
“Profesor i Asociuar”	☐	☐
“Profesor”	☐	☐
“Akademik”	☐	☐

Përvoja pedagogjike:

-Mësues i lëndës ____ vjet

-Pedagog i lëndës ____ vjet

____, më ____ . ____ . 202 ____

PËR BOTUESIN / SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

Shënim për plotësimin e formularit: Të dhënat përkatëse të pasqyrohen brenda kutisë duke përdorur simbolin “X”



SHTOJCA NR. 6: TË DHËNA PËR REDAKTORËT SHKENCORË/LETRARË DHE PËRKTHYESIT/PËRSHTATËSIT

1. Redaktorët shkencorë:

a) Redaktori i parë _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi :

2. Redaktorët letrarë:

a) Redaktori i parë _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

3. Përkthyesi/përshtatësi

a) I parë _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b) I dytë (në qoftë se ka) _____

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

_____, më _____. _____. 201____

PËR BOTUESIN/SHPËRNDARËSIN

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, firma, vula)

**SHTOJCA NR. 7: DEKLARATË E ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE****DEKLARATË**

I nënshkruari _____, anëtar i komisionit _____ në MA, deklaroj se nuk kam dorëzuar për konkurrim në MA tekst shkollor të ri, nuk jam i lidhur me interesa familjarë ose financiarë me punonjës të Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve të saj të varësisë.

Deklaroj, po ashtu, se me asnjë nga botuesit/shpërndarësit dhe me punonjës të këtyre institucioneve nuk kam lidhje për interesa familjare ose financiare.

DEKLARUESI

_____, më _____. _____. 202_____

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

SHTOJCA NR. 8: DEKLARATË E VLERËSUESIT/VLERËSUESIT PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**DEKLARATË**

Unë i nënshkruari _____, me të dhënat e mëposhtme, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në vlerësimin e teksteve shkollore të reja, sipas standardeve për tekstet shkollore dhe në përputhje me aktet ligjore për tekstet shkollore.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam autor i asnjë prej teksteve shkollore të reja.
- Nuk jam recensues, apo anëtar i ekipit realizues: redaktor shkencor, redaktor letrar, faqosës etj., i asnjë prej teksteve shkollore të dorëzuara për konkurrim në MA (komisionit).
- Nuk kam lidhje familjare apo të bashkëjetesës me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të teksteve shkollore të dorëzuara për konkurrim në MA (komisionit) etj.

DEKLARUESI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Mësues (pedagog) në shkollën (institucioni i arsimit të lartë)

Arsimi i kryer (institucioni i arsimit të lartë), fusha e studimit/programi i studimit

Telefon + celular: _____

E-mail _____

Adresa postare: Rruga _____ Lagjja _____ Bashkia/rrethi _____

Emri i bankës _____

IBAN _____ Nr. i llogarisë _____

_____, më _____. _____. 202_____



URDHËR

Nr. 190, datë 21.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, të urdhrit të Kryeministrit nr. 1, datë 8.1.2025, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm, për nënshkrimin e korrespondencave/shkresave dalëse, te drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve, znj. Alisa Basha.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të tij deri më datë 28.11.2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri znj. Alisa Basha dhe Drejtoria Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve, pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka

VENDIM

Nr. 53, datë 9.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 7.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Z) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Zyra e Përmbartimit Privat ARB” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

“Raiffeisen Bank” sh.a., në mungesë.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurës së gjyimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, për sa i përket çështjes nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë regjistrimi 13.3.2019, në lidhje me vendimin nr. 4868, datë 6.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 42, datë 21.1.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërbimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

Konstatimi i statusit të viktimës për gjatë procesit gjyqësor, si rrjedhojë e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin *Scordino kundër Italisë*.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të vendimit “Për plotësimin e të metave të kërkesës”, datë 30.4.2024, të Gjykatës së Lartë dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarës,



shoqërisë “Zyra e Përmbartimit Privat ARB” sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, “Raiffeisen Bank” sh.a. (*banka*) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (*KESH*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në ushtrim të funksionit të saj, kërkuesja ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in, me objekt kryerjen e shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit nr. 9031 akti, datë 13.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar të urdhrin të ekzekutimit, kërkuesja ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative drejtuar bankave të nivelit të dytë.

2. Kërkuesja ka pretenduar se banka në atë kohë ka kryer veprime të tilla që të krijojnë bindje të arsyeshme se ajo ka fshehur likuiditetet e debitorit, shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (*CEZ*) dhe se banka, organet dhe përfaqësuesit e saj, ka pasur fitime të drejtpërdrejta nga këto veprime të kundërligjshme. Për më tepër, banka nuk i ka dhënë kërkueses informacionin e kërkuar.

3. Në këto kushte, kërkuesja ka vlerësuar se mosekzekutimi i urdhrin të ekzekutimit i ka dëmtonuar asaj reputacionin e konsoliduar në treg, për rrjedhojë edhe fitimet, dhe në datën 28.5.2014 ajo i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër bankës, me palë të tretë KESH-in, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur t’i dëmshpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar me faj, fitimin e munguar, si dhe kamatat ligjore përkatëse sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4868, datë 6.6.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi nuk u vërtetua ekzistenca e ndonjë dëmi pasuror që t’i ketë ardhur paditëses (kërkueses) nga veprimet e të paditurit. Ajo gjykatë ka evidentuar se sipas kërkueses dëmi konsiston në fitimin e munguar që do të kishte realizuar shoqëria nga kontratat e shërbimit që shpresonte të lidhte në të ardhmen me

KESH-in. Në rastin konkret fitimi i munguar i pretenduar prej kërkueses është cilësuar nga gjykata si imagjinar, pasi nuk është provuar fakti se të gjithë titujt ekzekutivë me kreditor KESH-in do të viheshin në ekzekutim nga kërkuesja. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 42, datë 21.1.2019, me të njëjtën linjë arsyetimi.

5. Në datën 13.2.2019 kërkuesja ka ushtruar rekurs. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë 13.3.2019 regjistrimi, por nuk është gjykuar ende.

6. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, në datën 26.3.2021 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, bazuar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

7. Duke pretenduar se Gjykata e Lartë ishte në vonesë si për shqyrtimin e çështjes civile, ashtu edhe për shqyrtimin e kërkesës së saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, kërkuesja në datën 10.6.2021 ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar: i. konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile dhe shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm; ii. konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura (*kërkesa nr. 1*).

8. Gjykata, me vendimin nr. 39, datë 9.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit, duke konsideruar rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkueses, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t’u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

9. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës në Fletoren Zyrtare, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 9, datë 11.4.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave të paraqitur nga kërkuesja në datën 26.3.2021. Gjykata e Lartë ka arsyetuar, ndër të tjera, se procedura e shqyrtimit të rekursit të kërkueses ka



kaluar afatin ligjor, megjithatë tejkalimi i këtij afati është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive.

10. Në datën 18.7.2022 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 9, datë 11.4.2022, të Gjykatës së Lartë, si të papajtuës me Kushtetutën dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për rishqyrtimin e kërkesës (*kërkesa nr. 2*).

11. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 155, datë 16.11.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistonte ndonjë fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të mëparshëm të Gjykatës, që të kishte rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj. Sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, periudha kohore e kaluar nga publikimi në Fletoren Zyrtare të vendimit të mëparshëm të Gjykatës nuk ndryshonte substancialisht situatën e kërkuës në mënyrë të tillë që kërkesa e saj të konsiderohet si çështje e re për efekt të gjykimit kushtetues (*vendimi nr. 155/2022*).

12. Më pas, në datën 25.4.2024 kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë të re për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë. Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 77205-00024-00-2024 të regjistrimit themeltar, datë regjistrimi 29.4.2024 dhe me vendimin e datës 30.4.2024 të gjyqtarit relator kërkuës i është kërkuar plotësimi i të metave për shkak se mungonte nënshkrimi i avokatit. Në këto kushte, kërkesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë kërkesën e nënshkruar nga avokati dhe autorizimin përkatës.

13. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të paraqitur nga kërkuësja, me argumentin se tejkalimi i afatit ligjor për shqyrtimin e rekursit të saj nuk ka ardhur as për faj të palës, por as për faj të gjykatës, por është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive. Për më tepër, sipas atij kolegji, kërkesa është mbështetur vetëm në argumentin e tejkalimit të afatit 2-vjeçar dhe se kategoria e mosmarrëveshjes në fjalë nuk përfshihet në rrethin e asaj kategorie mosmarrëveshesh për të cilat parashikohet shqyrtimi me procedura të përsheptuara. Shqyrtimi

me përparësi i çështjes vetëm për shkak të paraqitjes së kërkesës nga kërkuësja, do të cenonte parimin kushtetues të barazisë para ligjit, sipas tij, i cili gjen zbatim edhe në rregullat e vendosura për radhën e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, ku çështja e regjistruar më parë në këtë shkallë gjykimi, sidomos me të njëjtën natyrë, ka përparësi ndaj çështjes së mbërritur më vonë, me përjashtim të rasteve kur veçantia e natyrës së çështjes dhe e rrethanave subjektive justifikojnë përjashtimin e radhës së gjykimit. Natyra e çështjes në rastin konkret është vlerësuar nga ai kolegji se nuk gëzon cilësi të veçanta të prioritetit të gjykimit.

14. Në datën 24.12.2024 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës duke paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij (*kërkesa nr. 3*). Kolegji në datën 12.3.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

15.1. *Së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e shkresës nr. 77205-00024-00-2024 të regjistrimit themeltar, datë 30.4.2024, “Vendim për plotësimin e të metave të kërkesës”, të Gjykatës së Lartë, përmes së cilës kërkohej plotësimi i kërkesës së datës 25.4.2024 së kërkuës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave. Në këtë mënyrë ajo gjykatë nuk zbaton as vendimet e detyrueshme të Gjykatës, e cila ka një praktikë të konsoliduar të lidhur me veprimin administrativ të kthimit të kërkesës për përsheptim nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Për më tepër që në interpretim të nenit 399/5, pika 2, shkronja “ç”, të KPC-së, kjo lloj kërkesë mund të bëhet nga kërkuësja dhe, vetëm në rast se bëhet nga avokati, nevojitet pajisja me prokurë.

15.2. *Së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi kërkesa e kërkuës drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e cenimit të afatit, në kundërshtim me nenin 399/6, shkronja “c” të KPC-së, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate



dhe jo nga një trupë tjetër civile (Kolegji Civil), edhe pse sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i saj përbëhet nga tre trupa të përhershme.

15.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme*, pasi Gjykata e Lartë e ka paragjykuar ose paracaktuar fatin e çështjes së themelit të kërkesës, duke ushtruar ndikim mbi Kolegjin Civil që do ta shqyrtojë atë, pasi në vendimin objekt kundërshtimi është shprehur se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme.

15.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar vonesën në shqyrtimin e kërkesave të përsëritura të kërkesues. Kjo pasi ajo gjykatë nuk ka referuar në asnjë fakt, provë, ligj, doktrinë ose precedent të vendosur nga gjykatat vendase dhe/ose të huaja kur ka nxjerrë përfundimin se vonesa e shkaktuar është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe as nuk ka përcaktuar ndonjë metodologji për përcaktueshmërinë e “pamundësisë objektive”. Ndërsa kur shprehet se kërkesja nuk ka paraqitur shkaqe veçanërisht të rënda që të justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse, ajo gjykatë nuk referon në asnjë vendimmarrje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në të cilën e bazon këtë konkluzion.

15.5. *Së drejtës për një mjet efektiv për konstatimin e cenimit, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave*, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 9.3.2019 dhe që prej asaj kohe, prej më shumë se 5 vjetësh, nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykimit të çështjes, përveç veprimtarisë administrative të shortimit dhe rishortimit të gjyqtarit relator. Për më tepër, ajo gjykatë në vendimin e saj nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024 shprehet se aktualisht Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë po përfundon shqyrtimin e çështjeve të themelit të regjistruara në vitin 2015 dhe se aktualisht janë në trajtim 298 çështje civile të vitit 2015 dhe rreth 2000 çështje të vitit 2016, të cilat kanë prioritet në trajtim. Gjykata e Lartë, me një *modus operandi* me rrezikshmëri të lartë për të drejtat individuale, “pamundësinë objektive” e gjeti të tillë me qëllim për të mos konstatuar statusin e viktimës

së kërkesues dhe për të mos e dëmshpërblyer atë sipas parashikimeve të nenit 399/3 të KPC-së. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk përbën më mjet efektiv për zgjidhjen e pretendimeve për vonesë të procedurave të gjykimit.

15.6. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, në veçanti në Gjykatën e Lartë, pasi:

15.6.1. KPC-ja ka parashikuar afate të prera për gjykimin e çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm dhe mjete për t'u ankuar nëse këto afate nuk zbatohen, ndërsa në rastin konkret afati 2-vjeçar i parashikuar me nenin 399/2, shkronja “b”, të KPC-së është tejkaluar me më shumë se 3 vjet të tjerë. Vetë kërkesja nuk ka ndikuar në asnjë prej rrethanave të parashikuara nga neni 399/2 i KPC-së për tejzgjatjen e afatit të gjykimit, ndërsa pasojat e ardhura nga zbatimi i reformës në drejtësi nuk përbëjnë shkak justifikues për tejkalimin e këtij afati.

15.6.2. Gjykata e Lartë, lidhur me kërkesën e kërkesues për konstatimin e cenimit të afatit, e ka marrë vendimin pas 75 ditësh dhe duke mos parashtruar asnjë argument për këtë, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së, i cili përcakton afatin ligjor 45-ditor për shqyrtimin e këtyre lloj kërkesave.

15.6.3. Përkeqësimi i “statusit të viktimës”, referuar nenit 34 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e rrëzimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, në rrethanat që i kanë ndodhur pas datës 11.1.2023 e në vijim ortakut të vetëm të kërkesues.

15.6.4. Interesi ekonomik i kërkesues dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm, tashmë në liri, po e çon kërkesen drejt falimentimit. Në kushtet kur edhe certifikata për ushtrimin e veprimtarisë është pezulluar nga Ministria e Drejtësisë, është bërë e pamundur për ortakun e shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit, duke konsideruar që ai është prind i një fëmije të mitur dhe kujdeset për nënën e sëmurë.

15.7. *Së drejtës së rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit*, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, kryesisht për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, veçanërisht në Gjykatën e Lartë, si dhe



për shkak të cenimeve të të drejtave të tjera të pretenduara nga kërkuesja.

16. **Subjektet e interesuara, banka dhe KESH-i**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në verifikim të kriterëve si më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

19. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që mund t'i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme,

në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijuese të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar me nr. 11118-00653-00-2019, datë 13.3.2019, për të cilën Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkueses për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

21. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 24.12.2024, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm mban datën 9.7.2024 dhe i është komunikuar asaj nëpërmjet adresës së *e-mail*-it në datën 7.10.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

22. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përsheptimin e procedurave, si dhe të drejtën për rehabilitim dhe dëmshpërblim në përputhje me ligjin.

23. Për pretendimin e kërkueses për t'u rehabilituar dhe dëmshpërblyer në përputhje me ligjin për shkak të tejzgjatjes së procedurave gjyqësore,



Gjykata ka theksuar edhe në vendimmarrje të saj të mëparshme ndaj kërkuësës (*shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 34, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), bazuar në nenin 131 të Kushtetutës dhe praktikën e GJEDNJ-së në raste të ngjashme, se ky pretendim i kërkuësës nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se kërkesa e saj drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 399/6, shkronja "c", të KPC-së, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate dhe jo nga një trupë tjetër civile, edhe pse sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i saj përbëhet nga tre trupa të përhershme. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vë në dukje se neni 399/6, shkronja "c", i KPC-së parashikon se në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave shqyrtohet nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, pa përcaktuar kolegjin që do ta marrë në shqyrtim. Për këtë pretendim Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk ka arritur të parashtojë argumente në nivel kushtetues për të provuar cenimin e së drejtës së saj si pasojë e shqyrtimit të kërkesës për përshpejtim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Civil, që të mund të justifikojë shqyrtimin e këtij pretendimi në nivel kushtetues.

25. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuësja ka argumentuar se Gjykata e Lartë e ka paragjykuar ose paracaktuar fatin e çështjes së themelit të kërkesës, duke ushtruar ndikim mbi Kolegjin Civil që do ta shqyrtojë atë, pasi në vendimin objekt kundërshtimi është shprehur se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme. Për këtë pretendim Gjykata eidenton se Gjykata e Lartë, duke analizuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht "rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësi" dhe në referencë edhe të vendimeve të gjykatave më të ulëta, ka konstatuar se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme. Ky argument i vetëm nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e

paanshme, ndaj edhe ky pretendim i kërkuësës nuk mund të merret në shqyrtim.

26. Po në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuësja ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *kohëzgjatjes së paarsyeshme* të procesit në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe në drejtim të së drejtës së aksesit dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat edhe pse janë ngritur si pretendime të mëvetshme, në thelb kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

27. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka tejkaluar ndjeshëm afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile të iniciuar prej saj, e cila është regjistruar në atë gjykatë në datën 9.3.2019 dhe ende nuk është gjykuar. Ajo gjykatë nuk rezulton të ketë pezulluar çështjen për shkaqe ligjore ose që ajo të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuëse. Prej asaj gjykate nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykimit të çështjes, përveç shortimit dhe rishortimit të herëpashershëm të gjyqtarit relator. Nga ana tjetër, ajo gjykatë nuk ka referuar në asnjë fakt, provë, ligj, doktrinë ose precedent të vendosur nga gjykatat vendase dhe/ose të huaja kur ka nxjerrë përfundimin se vonesa e shkaktuar është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe as nuk ka përcaktuar ndonjë metodologji për përcaktueshmërinë e "pamundësisë objektive". Ndërsa nuk referon në asnjë vendimmarrje të GJEDNJ-së kur shprehet për mungesën e shkaqeve veçanërisht të rënda që të justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse. Prej kësaj tejzgjatjeje interesi ekonomik i kërkuësës dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të saj, tashmë në liri, po e çon kërkuësen drejt falimentimit.



28. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përfshihen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 28.5.2014, duke kërkuar nga banka, palë e paditur, shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pretenduar, fitimin e munguar, si dhe kamatat ligjore përkatëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuar si të pambështetur në ligj. Kërkesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 13.2.2019 kërkesja ka paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë 13.3.2019 regjistrimi. Nga momenti i paraqitjes së kërkesëpadisë (28.5.2014) deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë kanë kaluar rreth 11 vjet, ndërsa nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë (13.3.2019) kanë kaluar rreth 6 vjet dhe ende nuk ka një vendimarrje për të.

30. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes civile, KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

31. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuar është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, do të analizohen rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuar; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë

rrezikon kërkuar (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në lidhje me *sjelljen e kërkuar*, Gjykata vëren se, sikurse ka pranuar edhe Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), nuk konstatohet ndonjë sjellje e kërkuar në veçanti ose e palëve në përgjithësi që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë e deri në shqyrtimin e saj në këtë Gjykatë nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesja ose palët në proces nuk rezultojnë të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

33. Për sa i takon *kompleksitetin e çështjes*, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile dhe rregullohet nga Kodi Civil. Si palë në këtë proces janë kërkuar, banka, në cilësinë e palës së paditur dhe KESH-i si person i tretë. Në objektin e padisë kërkohet shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror që kërkuar pretendon se i është shkaktuar nga banka për shkak të mosdebitimit të llogarisë së debitorit (CEZ-it) në favor të kreditorit (KESH-it), i cili është klient i kërkuar. Në vijim, Gjykata konstaton se procedurat përpara gjykatës së shkallës së parë kanë zgjatur përafërsisht 2 vjet dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuar. Po kështu, procedurat përpara Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 2 vjet e gjysmë dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

34. Gjykata ka theksuar se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse çështja mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti (*shih vendimin nr. 80, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata evidenton se kompleksiteti i çështjes konkrete është marrë në analizë më parë prej saj (*shih vendimin nr. 39, datë 9.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), duke arritur në përfundimin se çështja paraqet elemente kompleksiteti. Megjithatë, në referim të standardit të mësipërm kushtetues dhe nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë,



Gjykata vlerëson se edhe pse në dukje çështja mund të ketë elemente kompleksiteti, kjo nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit në atë gjykatë.

35. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se çështja e kërkuarës është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Lartë prej përrreth 6 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është përrreth 11 vjet.

36. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e kërkuarës për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, Gjykata vë në dukje se Kolegji Civil po përfundon shqyrtimin e çështjeve të regjistruara në vitin 2015 dhe se deri në datën e atij vendimi kanë qenë në trajtim 298 çështje civile të vitit 2015 dhe rreth 2000 çështje të vitit 2016, të cilat kanë prioritet në trajtim. Gjykata e Lartë ka çmuar se mosgjykimi i kësaj çështjeje nuk rezulton që të jetë rrjedhojë e veprimeve penguese të palëve ndërgjyqëse ose gjykatës, por rrjedhojë e shkaqeve të pavarura nga vullneti i tyre, të cilësuar si “pamundësi objektive për procedim” për shkak të mospasjes së përkohshme të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përballimin brenda limiteve të arsyeshme të stokut të çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë. Për më tepër, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet ku kategoria e mosmarrëveshjes për të cilën është kërkuar përshpejtimi i gjykimit nuk përfshihet në rrethin e mosmarrëveshjeve për të cilat parashikohet shqyrtimi me procedura të përshpejtuara, si dhe nisur nga fakti se kërkuarja nuk ka parashtruar shkaqe veçanërisht të rënda, që justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse, përshpejtimi i çështjes vetëm për shkak të paraqitjes së kërkesës nga kërkuarja do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës.

37. Nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se për çështjen është zgjedhur gjyqtari relator A.K., por nuk rezulton të jetë planifikuar një datë për shqyrtimin e rekursit të kërkuarës. Ndërkohë, nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Lartë me *e-mail*-in e datës 29.9.2025, çështja civile nr. 11118-0065300-2019 rezulton se është në fazë studimi.

38. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuarës lidhet me ngarkesën në Gjykatën e Lartë shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Në këtë

drejtim, Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe KL.GJ-ja tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024, nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Po në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuarja ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të saj, e cila i është kthyer për plotësimin e të metave, me arsyetimin se duhej nënshkruar nga një avokat dhe se duhej paraqitur akti i përfaqësimit, ndonëse kërkesa ishte nënshkruar nga kërkuarja. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një pengesë të aksesit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka detyrimin të sillt në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 37, datë 5.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, edhe pse kërkuarja ka shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion të saj, duke e paraqitur kërkesën për përshpejtim në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar themelin e kërkesës, duke mbajtur një qasje formaliste dhe duke e shndërruar kërkesën në fjalë në mjet ankimi joefektiv.

40. Për sa i takon *rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuarja*, sipas kërkuarës, ajo lidhet me interesin ekonomik të saj dhe atë personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor të ortakut të vetëm të saj, që rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore, për shkak se masa



e arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm, e cila nuk është më në fuqi, po e çon kërkuiesen drejt falimentimit dhe nuk i jep mundësi ortakut të shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit.

41. Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuësit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuësit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Ndërsa GJEDNJ-ja ka pohuar se palët e një mosmarrëveshje civile që nuk ka nevojë për ndonjë prioritet të veçantë, sidoqoftë kanë të drejtë, sipas nenit 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, të dëgjoen brenda një afati të arsyeshëm. Në lidhje me këtë, atyre nuk iu kërkohej që të provojnë se për shkak të vonësive procedurale iu është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë. GJEDNJ-ja ka pranuar – në një linjë me këtë Gjykatë – se në përpjekje për të trajtuar numrin e madh të çështjeve të prapambetura dhe për të garantuar trajtim të drejtë për të gjitha këto çështje, gjykatat vendase mund të kenë hapësira të kufizuara për të përdorur mjetet përshpejtuese të ofruara nga juridiksioni vendas për çështjet joprioritare, sidoqoftë, sipas saj, shtetit ende i kërkohej që të ofrojë një mjet kompensues efektiv në rrethana të tilla. Duke mbajtur në konsideratë vonësën prej tetë vjetësh dhe gjashtë muajsh pranë Gjykatës së Lartë në një rast, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se është shkelur kërkesa për një “afat të arsyeshëm” sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së (*shih ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesat nr. 39860/19 dhe 3 të tjera, datë 27.5.2025, §§§ 118, 122, 124*).

43. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuësen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata evidenton se, sikurse kanë arsyetuar gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, nuk ka rezultuar që kërkuësja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të

cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave të mëtejshme të shërbimit me shoqëritë KESH dhe OST, duke qenë se në rastin konkret fitimi i munguar i pretenduar prej kërkuëses është cilësuar prej gjykatës si imagjinar, pasi nuk është provuar fakti se të gjithë titujt ekzekutivë me kreditor KESH-in do të viheshin në ekzekutim nga kërkuësja. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuëses nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë edhe listën e çështjeve që duhet të gjykohen me përparësi, si dhe objektin e padisë që lidhet me detyrimin e bankës, për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Megjithatë, mungesa e shqyrtimit të saj nga Gjykata e Lartë pas 6 vjetësh ka cenuar të drejtën e kërkuëses për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

44. Në përfundim, Gjykata, në konsideratë edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me disa çështje kundër Shqipërisë, çmon se edhe vetëm kohëzgjatja në tërësi e gjykimit në rastin konkret përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave, për rrjedhojë kërkuëses i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj kërkesa e saj duhet të pranohet.

45. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë dhe mundësitë aktuale të Gjykatës së Lartë, çmon se, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.



2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2946, datë 9.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.10.2025.

Shpallur më 20.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 59, datë 16.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 16.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 3 (I) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: ISUF DASHI

SUBJEKT I INTERESUAR:

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE,

BERAT, përfaqësuar nga drejtori, Altin Kazazi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2399/2516, datë 30.5.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-3568, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së

Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet dhe prapësimet e kërkuarit Isuf Dashi (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Berat, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura nga data 16.6.1982. Ai ka dalë në rezervë në datën 1.9.2004, ndërsa mbante gradën “Kapiten” dhe me një vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv prej 22 vjetësh e 2 muajsh.

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare deri në datën 1.9.2006, kërkuesi, në vijim, është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi (*pension i parakohshëm*). Me vendimin nr. 735, datë 5.2.2007 (*vendimi nr. 735/2007*), DRSSH-ja, Berat i ka caktuar atij pension të parakohshëm në masën 16.480 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 1.9.2006, duke u bazuar në ligjin nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8087/1996*). Pensioni i parakohshëm është llogaritur sipas nenit 11 të këtij ligji, në masën 50% të pagës referuese, mbi të cilën është derdhur kontributi për 15 vjet punë, e shtuar kjo me 2% të pagës referuese, mbi 15 vjet punë, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal në shkallë vendi.



3. Në vijim, me vendimin nr. 735/1, datë 20.10.2011 (*vendimi nr. 735/1/2011*), DRSSH-ja, Berat ka rillogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuarit, me efekt nga data 1.7.2009 e në vazhdim. Rillogaritja e pensionit është bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*).

4. Në datën 15.10.2014, duke mos qenë dakord si me llogaritjen fillestare, ashtu edhe me rillogaritjen e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, kërkuar i është drejtuar DRSSH-së, Berat, duke i kërkuar rillogaritjen e këtij pensioni sipas nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9210/2004*). Në përgjigje, me shkresën nr. 3622/1, datë 19.11.2014, DRSSH-ja, Berat është shprehur se llogaritja dhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm janë bërë në përputhje me ligjin dhe me vendimin nr. 2, datë 18.2.2013 (*vendimi nr. 2/2013*), të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

5. Në datën 17.12.2014 kërkuar i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Berat: i. të revokojë vendimin nr. 735/2007 dhe t'i rillogarisë, ricaktojë dhe paguajë masën e pensionit të parakohshëm në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, nga data 1.9.2006 dhe deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie; ii. të revokojë vendimin nr. 735/1/2011 me të gjitha efektet negative të tij nga data 1.7.2009 e në vazhdim; iii. t'i paguajë diferencat midis masës së pensionit sipas nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004 dhe pensionit të paguar, së bashku me kamatëvonesat, nga data 1.9.2006 dhe deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 586, datë 29.4.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuarit, sipas objektit të saj. Kjo gjykatë, në mënyrë të përmblodhur, ka arsyetuar se llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuarit nga DRSSH-ja, Berat është bërë në kundërshtim me nenin 35, pika 1, të ligjit nr.

9210/2004, që ka qenë në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për të, përveçse ajo kishte zbatuar një dispozitë të shfuqizuar, shkronjën “b” të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, për kufizimin e pensionit të parakohshëm të kërkuarit në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuarin sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9210/2004 dhe me vetë përmbajtjen e këtij neni (nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009), por edhe me vendimin e Gjykatës nr. 33, datë 24.6.2010 (*vendimi nr. 33/2010*), duke cenuar parimin e sigurisë juridike, për sa kohë rillogaritja ka ndikuar negativisht në situatën e kërkuarit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, DRSSH-ja, Berat.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2399/2516, datë 30.5.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuarit. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmblodhur, ka arsyetuar se ndonëse në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuarin, në datën 1.9.2006, ka qenë në fuqi ligji nr. 9418/2005, në zbatim të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 3/2016*), ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuarit është ligji nr. 8087/1996. Për rrjedhojë, llogaritja, caktimi dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuarin është bërë në përputhje me ligjin. Edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuarin është në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe me vendimin nr. 2/2013 të Gjykatës, ku është arritur në përfundimin se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka prekur parimin e sigurisë juridike, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, duke respektuar ajo kriteret kushtetuese të nenit 17/1 të Kushtetutës. Në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe në vendimin unifikues nr. 3/2016, është arritur në përfundimin se rillogaritja e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 i ligjit nr. 10142/2009 do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, edhe në situatën kur kjo rillogaritje ul masën e pensionit të parakohshëm të njohur dhe të caktuar më parë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuar.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3568, datë 19.9.2024, në



dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Sipas atij kolegji, shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila u ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave ligjore të zbatueshme, konkretisht ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142/2009, duke i dhënë meritën çështjes në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Po sipas atij kolegji, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

9. Në datën 15.1.2025 kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar më 23.1.2025. Në datën 23.3.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 23.4.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuarisi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar dhe nuk u ka kthyer përgjigje shkaqeve të ngritura në rekursin e tij, ndonëse ato kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit, që ishin të një rëndësie themelore, ashtu edhe me parimin e sigurisë juridike në aspektin e të drejtave të fituara.

10.1.2. *Parimit të sigurisë juridike në aspektin e së drejtës së fituar*, pasi:

10.1.2.1. Ndonëse e drejta për pension të parakohshëm kërkuarisi i ka lindur në datën 1.9.2006, dhe ajo rregullohej nga ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 dhe në mosrespektim

edhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 (*vendimi unifikues nr. 3/2013*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, masa e pensionit atij i është llogaritur sipas ligjit nr. 8087/1996, megjithëse ky ligj nuk zbatohet në rastin e tij. Si pasojë e kësaj, kërkuarisi i është cenuar masa e pensionit me 8.032 lekë në muaj. Në vendimin unifikues nr. 3/2016 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur të mos zbatohen ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, por ligji nr. 8087/1996 së bashku me kufizimin e tij në shkronjën “b” të nenit 11, megjithëse ky kufizim ishte shfuqizuar duke filluar nga data 14.4.2004.

10.1.2.2. Masa e pensionit është përligjur edhe në zbatim të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, duke i dhënë atij fuqi prapavepruese, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës nr. 33/2010, ku është përcaktuar qartë se rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Për më tepër, kërkuarisi nuk është as subjekt i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, pasi objekt rillogaritjeje, sipas tij, janë pensionet e parakohshme të përfituara sipas ligjit nr. 8087/1996 dhe jo ato sipas ligjeve nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005. Si pasojë e kësaj, pas datës 1.7.2009, kërkuarisi i është ulur masa e pensionit të parakohshëm me 19.998 lekë në muaj.

10.2. *Parimi i shtetit të së drejtës dhe ai i hierarkisë së akteve normative*, pasi gjykatat e zakonshme në vendimet e kundërshtuara:

10.2.1. Nuk kanë zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në datën 1.9.2006, në momentin e lindjes për kërkuarisin të së drejtës së pensionit të parakohshëm, pikërisht ligjin nr. 9210/2004. Ato kanë zbatuar ligjin nr. 8087/1996, megjithëse ligji nr. 9210/2004 bën pjesë në listën e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës. Për më tepër, ligji nr. 8087/1996, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9418/2005, nuk zbatohet për ushtarakët që përfitonin sipas këtij të fundit (neni 33). Po kështu, është zbatuar kufizimi sipas shkronjës “b” të nenit 11 të këtij ligji (ligjit nr. 8087/1996), në një kohë kur ky kufizim ishte shfuqizuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004.

10.2.2. I kanë dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, megjithëse kjo dispozitë parashikon rillogaritjen e përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 8087/1996, por jo edhe të atyre sipas ligjeve nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005. Si pasojë, kërkuarisi i janë cenuar të drejtat e fituara dhe, për më



tepër, në mosrespektim të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, e cila, në interpretim pajtues të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, ka arritur në përfundimin se rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve.

10.3. *Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk kanë respektuar vendimet e Gjykatës nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013, përmes të cilave është pranuar se zvogëlimi i pensionit të parakohshëm nuk mund të përlligjej me interesin publik, se rillogaritja e pensionit sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 do të bëhej vetëm në rast se ndryshonte pozitivisht situatën e përfituesve dhe se prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhej kurrësi të pësonte ndryshime të tilla që të përkeqësonin ndjeshëm jetën e shtetasve, të cilët përfitonin këtë sigurim. Edhe pse ishin përpara një të drejte që buronte nga neni 52, pika 2, i Kushtetutës dhe të njohur me ligj të miratuar me shumicë të cilësuar, gjykatat kanë zvogëluar masën e pensionit të tij të parakohshëm pa marrë parasysh këto vendime të Gjykatës. Vendimi unifikues nr. 3/2016 ka përcaktuar rillogaritjen në përkeqësim të pensionit të parakohshëm.

11. **Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Berat**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës* nuk qëndron, pasi DRSSH-ja, Berat e ka përlllogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuarit bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, sipas kufizimit të vendosur në shkronjën “b”, pra jo më shumë se masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Kufizimi i masës së përfitimit ekziston jo vetëm në ligjin e sigurimeve shoqërore, por edhe në ligjet për sigurimet shoqërore suplementare, ndaj një mënyrë e ndryshme të vepruar nga ajo do të ishte në zbatim të gabuar të ligjit, duke abuzuar me fondet e buxhetit të shtetit. Pensioni i parakohshëm i kërkuarit është përlllogaritur në përputhje të plotë me ligjin nr. 10142/2009 dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij, sikundër edhe me udhëzimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

11.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike në aspekt të së drejtës së fituar* nuk qëndron, pasi ligji nr. 10367, datë 23.12.2010, i cili ndryshoi ligjin nr. 10142/2009, iu nënshtroi kontrollit kushtetues dhe Gjykata, me vendimin nr. 2/2013, ka vlerësuar se megjithëse skema e re e përlllogaritjes së masës së sigurimeve suplementare ka sjellë uljen e të

ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përppjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, pasi masa e pensionit e përlllogaritur sipas formulës së re mbështetet në mundësitë reale buxhetore, siguron funksionimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare dhe ruan raporte të arsyeshme midis masës së sigurimit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vëren se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimet e kundërshtuara të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të dhëna në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës kushtetuese, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në



çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 24, datë 23.4.2025; nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin për të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur me vendimin unifikues nr. 3/2016, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij në këndvështrim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.9.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.1.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike, përveç edhe të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve, si dhe të standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Në lidhje me këto

pretendime, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka paraqitur të njëjtat argumente që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, prandaj ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

19. Kërkuesi ka pretenduar se masa e pensionit të parakohshëm të caktuar nga DRSSH-ja, Berat nuk është bazuar në ligjin në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, por në ligjin nr. 8087/1996, i cili nuk ka qenë i zbatueshëm në rastin e tij dhe, për më tepër, duke konsideruar atë kufizim të masës së pensionit që ky i fundit parashikonte, në një kohë kur ky kufizim ishte shfuqizuar prej datës 14.4.2004, përmes nenit 49 të ligjit nr. 9210/2004. Po ashtu, edhe rillogaritja në vijim e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është bërë në shkelje të përmbajtjes së kësaj dispozite, përveçse kjo dispozitë bie ndesh me ligjin nr. 9210/2004, i cili bën pjesë në listën e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat, për sa i përket përcaktimit të masës së përfitimit të këtij pensioni, nuk kanë interpretuar e zbatuar drejt jurisprudencën kushtetuese dhe legjislacionin e fushës, në cenim të parimit të sigurisë juridike në aspekt të të drejtave të fituara. Po sipas tij, edhe për sa i përket rillogaritjes së masës së pensionit të parakohshëm, interpretimi që këto gjykata u kanë bërë dispozitave ligjore dhe vendimeve të Gjykatës, si dhe zbatimi i vendimit unifikues nr. 3/2016 kanë bërë që ajo rillogaritje të jetë në përkeqësim të situatës së tij financiare, duke cenuar edhe në këtë rast parimin e sigurisë juridike. Po sipas kërkuesit, edhe pse shkaqet e ngritura në rekursin e tij kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit dhe me cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar dhe nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e tyre në ligj.

20. Subjekti i interesuar ka prapësuar se llogaritja e pensionit të parakohshëm të kërkuesit është bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, sipas



kufizimit të vendosur në shkronjën “b”, pra jo më shumë se masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Ky lloj kufizimi i masës së përfitimit ekziston jo vetëm në ligjin e sigurimeve shoqërore, por edhe në ligjet për sigurimet shoqërore suplementare, ndaj një mënyrë e ndryshme të vepruari do të ishte në zbatim të gabuar të ligjit, duke abuzuar me fondet e buxhetit të shtetit. Për pasojë, sipas subjektit të interesuar, pensioni i parakohshëm i kërkuesit është llogaritur në përputhje të plotë me ligjin, përfshirë edhe periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009. Ky i fundit, sipas tij, u ndryshua me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010 dhe iu nënshtroa kontrollit kushtetues. Gjykata, me vendimin nr. 2/2013, ka vlerësuar se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimeve suplementare ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë, pasi formula e re për llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm mbështetet në mundësitë reale buxhetore, siguron funksionimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare dhe ruan raporte të arsyeshme midis masës së sigurimit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna.

21. Duke sjellë në vëmendje se neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon edhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon të rrithekojë se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrar ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 24, datë 23.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së

drejtës, Gjykata çmon të rrithekojë se ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykojnë, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 78, datë 6.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të



ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 1, datë 31.1.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata gjithashtu çmon të rritetshëm se edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Lidhur me legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tij kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuere të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, Gjykata e ka bërë tashmë në disa raste (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025 §§ 26-35; nr. 25, datë 23.4.2025 §§ 42-48; nr. 24, datë 23.4.2025 §§ 25-31*), ndaj çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

26. Mbi atë bazë, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuarit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuarit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuarit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuarit, si ushtarak i dalë në rezervë, e drejta për pension të parakohshëm i ka lindur në datën 1.9.2006. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 16.480 lekë

në muaj, sipas aktit administrativ, vendimit nr. 735/2007 të DRSSH-së, Berat (*shih paragrafin 1 të vendimit*). Në vijim, me një akt tjetër administrativ, vendimin nr. 735/1/2011, DRSSH-ja, Berat ka rillogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuarit sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 (*shih paragrafin 2 të vendimit*). Duke mos qenë dakord me llogaritjen fillestare, ashtu edhe me rillogaritjen në vijim të pensionit të parakohshëm, sipas këtyre akteve administrative, kërkuari ka paraqitur ankim përpara DRSSH-së, Berat, e cila i ka kthyer përgjigje negative (*shih paragrafin 3 të vendimit*). Pas kësaj, kërkuari ka kundërshtuar gjyqësisht aktet administrative në fjalë, duke kërkuar revokimin e tyre dhe detyrimin e organit administrativ t'i rillogarisë dhe t'i paguajë atij pensionin e parakohshëm në përputhje me masën e përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, si dhe t'i paguajë diferencat e këtij pensioni, së bashku me kamatëvonesat, nga data 1.9.2006, deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor (*shih paragrafin 4 të vendimit*).

28. Padia e kërkuarit është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, e cila, me vendimin nr. 586, datë 29.4.2015, ka vendosur pranimin sipas objektit të saj. Sipas asaj gjykate, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuarit në çastin e lindjes të së drejtës, në datën 1.9.2006, nuk ka qenë ligji nr. 8087/1996, por ligji nr. 9210/2004 dhe referuar nenit 35, pika 1, të tij, masa e këtij pensioni në këtë datë, e llogaritur nga vetë pala e paditur, është 24.512 lekë (për 22 vjet vjetërsi shërbimi dhe pagën referuese 38.300 lekë) dhe jo 16.480 lekë. Për rrjedhojë, llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuarit është bërë në kundërshtim me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004. Për më tepër, sipas asaj gjykate, kufizimi i masës së pensionit të parakohshëm të kërkuarit sa pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi është bërë në bazë të shkronjës “b” të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, në një kohë kur ky kufizim sipas kësaj shkronje ishte shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004.

29. Po sipas asaj gjykate, edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuarin sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është bërë në kundërshtim: i. me ligjin nr. 9210/2004, i cili, referuar nenit 81, pika 2, shkronja “e”, të Kushtetutës, bën pjesë në kategorinë e atyre ligjeve që miratohen me shumicën e cilësuar, ndërsa ligji nr.



10142/2009, i cili ka dalë në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9210/2004, bën pjesë në ligjet e zakonshme që miratohen me shumicën e thjeshtë, ndaj ai nuk mund të ndryshojë atë që ka përcaktuar ligji organik (ligji nr. 9210/2004); ii. me vetë përmbajtjen e këtij neni (nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009), i cili lejon rillogaritjen vetëm të atyre përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 8087/1996, por jo edhe për ato të caktuara sipas ligjit nr. 9210/2004; iii. me vendimin e Gjykatës nr. 33/2010, ku është mbajtur qëndrimi se rillogaritja do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve, përndryshe cenohet parimi i sigurisë juridike. Ndonëse Gjykata në vendimin nr. 2/2013 ka pranuar se vetëm skema e sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet të pësojë ndryshime që përkeqësojnë ndjeshëm jetën e shtetasve, duke lejuar ndryshime të skemës së përfitimeve suplementare, në rastin konkret jemi para një pensioni të parakohshëm të ushtarakut, i cili përbën një të drejtë sipas nenit 52, pika 2, të Kushtetutës, e drejtë kjo që rregullohet sipas kushteve të ligjit, që në këtë rast është ligji nr. 9210/2004.

30. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 2399/2516, datë 30.5.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuar. Sipas gjykatës së apelit, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të kërkuar ka qenë ligji nr. 8087/1996. Sipas saj, ndonëse në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuar, në datën 1.9.2006, në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 3/2016, kanë arritur në përfundimin se për periudhën nga data 1.1.1999 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përlllogaritet sipas ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe se në rastet kur e drejta për pension ka lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9418/2005 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, në kuptim të nenit 29 të këtij ligji, skema për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, e parashikuar nga ligji nr. 9418/2005 dhe e ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, nuk zbatohet, pavarësisht nëse masa e pensionit rritet ose ulet në raport me skemën e parashikuar nga ligji nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, llogaritja, caktimi dhe pagimi i pensionit të

parakohshëm për kërkuar është bërë në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës.

31. Po sipas gjykatës së apelit, edhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuar është në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe me vendimin nr. 2/2013 të Gjykatës, ku është arritur në përfundimin se megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, pra ka prekur parimin e sigurisë juridike, kjo ndërhyrje është në përputhje me qëllimin që e ka diktuar atë, duke respektuar ajo kriteret kushtetuese të nenit 17/1 të Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legjislative, si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror. Skema e re e rillogaritjes, sipas ligjit nr. 10142/2009, vijon gjykata, është gjetur e aplikueshme pas datës së miratimit të këtij ligji dhe në përputhje me Kushtetutën jo vetëm sipas vendimit në fjalë të Gjykatës, por, në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe në vendimin unifikues nr. 3/2016, është arritur në përfundimin se rillogaritja e pensionit të parakohshëm sipas nenit 29 i ligjit nr. 10142/2009 do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj edhe në situatën kur kjo rillogaritje ul masën e pensionit të parakohshëm të njohur dhe të caktuar më parë.

32. Për rekursin e kërkuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3568, datë 19.9.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se pretendimeve në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shtues nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila u ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave ligjore të zbatueshme, konkretisht ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142/2009, duke i dhënë meritën çështjes në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Sipas atij kolegji, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

33. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuar i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 1.9.2006, moment në të cilin kjo e drejtë rregullohej



nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, për të cilën përcaktohej se ajo ishte 50% e pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, por masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 3-fishi i pensionit bazë për ushtarakët e tjerë (për ata që nuk mbanin gradat “Gjeneral”, “Kolonel”, “Major” dhe “Nënkolonel”). Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, sipas shkronjës “b” të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, si dhe parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se ai do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohet tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) ose që ky kufizim do të ishte deri në 3-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

34. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht momentit kur kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm dhe ligjit në fuqi në atë moment, konkretisht ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohet, por zbatohet ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë). Për këtë, ajo gjykatë i është referuar përfundimit të arritur në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave, referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën nga data 1.1.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përlogaritet sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe për përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i

ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), ligj i cili nuk zbatohet. Po sipas atyre kolegjeve, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit është në përputhje me Kushtetutën, sikurse është vlerësuar edhe në vendimet e Gjykatës nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Megjithatë, objekt rregullimi i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është rillogaritja e të drejtave të njohura, ku pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë, por as për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 ose rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po kështu, edhe në vendimet e referuara të Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr. 10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave, të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave ose marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi.

35. Gjithashtu, përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse me ligjin nr. 9210/2004 tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar, Gjykata Administrative e Apelit për pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 1.9.2006–30.6.2009, duke u bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar edhe ajo se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohet, pasi nuk kishin dalë aktet nënligjore në zbatim të tij.

36. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit duket se nuk ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, si dhe nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas kushteve e kriterëve të parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.



37. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004 dhe e nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyra e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit nuk shprehet se përse ligji nr. 9210/2004, i identifikuar nga gjykata administrative e shkallës së parë si i zbatueshëm në rastin konkret ose dhe ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar nga gjykata e apelit si ligji që ka qenë në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, janë të pazbatueshëm për periudhën 1.9.2006–30.6.2009 dhe se i tillë është ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk shprehet as se përse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues për periudhën në fjalë dhe as se përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm nga gjykata e apelit (ligji nr. 8087/1996) vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 1.9.2006–30.6.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

38. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Për sa i përket këtij të fundit, ajo gjykatë nuk mund të mjaftojë me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti në drejtim të masës së kufizimit të pensionit të parakohshëm të kërkuesit për periudhën 1.9.2006–30.6.2009. Prandaj, vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji. Ndërkohë për sa u përket pretendimeve të kërkuesit në lidhje me nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra pas datës 1.7.2009, Gjykata

vëren se interpretimi i kësaj dispozite nga gjykata e apelit dhe pranimi i tij nga Gjykata e Lartë nuk duket i paarsyeshëm dhe që të bjerë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pra i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Prandaj, pretendimet e kërkuesit në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm për periudhën 1.7.2009 e në vijim nuk janë të bazuara.

39. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit, në lidhje me periudhën 1.9.2006–30.6.2009, është i bazuar. Megjithatë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

40. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3568, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.10.2025.

Shpallur më 20.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini



VENDIM

Nr. 00-2025-4083 (79), datë 18.2.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi - kryesues;
Arbena Ahmeti - anëtare;
Asim Vokshi - anëtar;
Gentian Medja - anëtar;
Enkelejda Metalaj (Softa) - anëtare,

dhe sekretare gjyqësore Katerina Bilo, në seancë gjyqësore datë 18.2.2025, mori në shqyrtim çështjen administrative nr. 31003-00018-00-2024 akti, që u përket:

PADITËS: Agjencia Shtetërore e Kadastrës
Drejtoria Vendore Tiranë-Rurale 2.

TË PADITUR: Nazmi Beqiri

Flora Beqiri

Ermir Beqiri

OBJEKTI: Detyrimin e familjes bujqësore me përfaqësues, Nazmi Beqiri, të paguajë vlerën monetare për pasurinë e shitur prej 2600 m², në shumën 1.164.800 lekë.

BAZA LIGJORE: Neni 10 i ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 58/2012; neni 115 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative; neni 32 i Kodit të Procedurave Civile; ligji nr. 33, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”; ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS
SË LARTË,

- Zhvilloi seanca gjyqësore më datë 22.1.2025 dhe më datë 18.2.2025, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore.¹

- Si u relatua çështja administrative prej gjyqtarës relatore, Arbena Ahmeti, dëgjoi palën rekursuese të përfaqësuar prej Avokaturës së Shtetit, që në përfundim kërkoi: - ndryshimin e vendimit të Gjykatës

Administrative të Apelit, si dhe të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe pranimin e padisë, dëgjoi palën e paditur të përfaqësuar prej avokatit Lulzim Koka, që në përfundim kërkoi: - lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe si e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Familja, palë e paditur në gjykimin administrativ, rezultoi se, është pajisur nga Komisioni i Ndarjes së Tokës i fshatit Kashar, me Aktin e Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi (AMTP) nr. 461, viti 1992. Familja ka marrë në pronësi tokë të llojit arë, me sipërfaqe prej 2600 m² në fshatin Kashar, Tiranë. Ndarja e tokës është bërë në bazë të numrit të anëtarëve të familjes dhe normës për frymë, në atë fshat. AMTP-ja është regjistruar në regjistrat publikë me nr. 205/15 pasurie, volumi 16, faqja 16, zona kadastrale nr. 2015, Tiranë.

2. Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KVTP) pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë, mbi bazën e kërkesës së disa shtetasve ka nisur procedurën administrative për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 461, viti 1992. Gjatë procedimit administrativ prej kadastrës (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë) është konfirmuar fakti se është regjistruar toka në bashkëpronësi të familjes, sipas AMTP-së përkatëse.

3. Në mbyllje të procedimit administrativ, KVTP-ja ka marrë vendimin nr. 167, datë 27.5.2016, me të cilin ka vendos: “Shfuqizimin e plotë të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi me nr. 461, datë 1992, me sipërfaqe 2600 m² në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga Nazmi Beqiri lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës i fshatit Kashar, Njësia Administrative Kashar. Kthimin në pronësi shtet të sipërfaqes 2600 m² regjistruar në ZVRPP Tiranë nr. pasurie 205/15, vol 16. faqe 16, ZK 2105”. KVTP-ja ka vlerësuar, se: “(...) Nazmi Beqiri hyn në kategorinë e përfutuesve nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, por duhet të pajisej me tokë bujqësore nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Yrshek, ku ishte me gjendje civile, më datë 1.8.1991, dhe jo

¹ Vendimi i ndërmjetëm datë 23.7.2024, i Kolegjit Administrativ për njësimin e praktikës gjyqësore për çështjen përkatëse është njoftuar me anë të publikimit dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si Faqe | 27782



nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Kashar, në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”

4. Prefekti i Qarkut Tiranë, në zbatim të përgjegjësiëve administrative, sipas nenit 10 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, ka paraqitur më datë 13.6.2016, padinë në gjykatën kompetente, me objekt kërkimi: - deklarin e pavlefshëm të AMTP-së dhe kthimin e sipërfaqes në pronësi shtet.

5. Gjatë gjykimit administrativ, pala e paditur ka paraqitur si provë, kontratën noteriale me të dhëna: nr. 57 rep.; nr. 26 kol., datë 7.1.2011, për shitjen e pronës së përfutur sipas AMTP-së, palës blerëse, shoqërisë tregtare “K&M Oil” sh.p.k., për vlerën totale prej 1.164.800 lekësh.

6. Pala paditëse ka kërkuar ndryshimin e objektit të padisë dhe kërkesa është miratuar prej gjykatës. Hetimi gjyqësor dhe gjykimi ka vijuar për padinë administrative, me objekt kërkimi dhe shkakut ligjor, si më lart përmendet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

7. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë**, me vendimin nr. 4687 (80-2016-4727), datë 12.10.2016, ka vendosur:

“Rrëzimin e padisë [...]”

7.1. Gjykata administrative e shkallës së parë arsyeton, se (...) nga verifikimi i akteve ligjore dhe nënligjore (ligji nr. 7501/1991, VKM nr. 230/1991, VKM nr. 255/1991 dhe udhëzimi nr. 2/1991), rezulton se ndarja e tokës bujqësore bëhet mbi bazën e gjendjes civile më datën 1 gusht 1991. Sipas certifikatës familjare, Nazmi Beqiri në atë datë ka qenë banor i fshatit Yrshek, jo Kashar. Për rrjedhojë, AMTP-ja nr. 461, viti 1992 është lëshuar në kundërshtim me dispozitat përkatëse.

7.2. Gjykata arrin në përfundimin, se AMTP-ja nr. 461, viti 1992, në emër të Nazmi Beqirit nuk ka vlefshmëri juridike. Megjithatë, duke qenë se pala paditëse nuk ka kërkuar shfuqizimin e këtij akti, gjykata nuk mund ta shfuqizojë kryesisht, pasi, sipas nenit 6 të KPC-së: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Në respektim të këtij detyrimi procedural, gjykata nuk mund të shprehet për shfuqizimin e AMTP-së nr. 461, viti 1992, në emër të Nazmi Beqiri, për sa kohë nuk është kërkuar nga pala paditëse. Pra, gjykata nuk mund të rregullojë pasojat juridike që ka prodhuar

ky akt administrativ, duke detyruar palët e paditura që të paguajnë vlerën monetare për pasuritë e paluajtshme prej 2600 m², e cila i është shitur të tretëve në shumën 1.164.800 lekë; kjo referuar edhe pikës 3, të nenit 9, të nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, në të cilin parashikohet: kur mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, të lëshuar në kundërshtim me ligjin, nuk e posedon më tokën në mënyrë të plotë ose të pjesshme, si pasojë e transaksionit të realizuar ose të shpronësimit për interes publik të kryer, detyrohet që për sipërfaqen përkatëse të tokës së shitur ose të shpronësuar të kryejë pagesën e kësaj toke, vlera e së cilës llogaritet me çmimet, sipas hartës së vlerës së tokës të AKKP-së, bazuar në metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme, miratuar me vendim të Kuvendit. Për sa më sipër, gjykata vlerëson se e drejta subjektive e pretenduar nga pala paditëse nuk gjen mbrojtje juridike nëpërmjet këtij objekti të kërkesëpadisë, dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

8. Kundër këtij vendimit ka ushtruar ankim Avokatura e Shtetit, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e padisë.

9. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 494 (86-2023-720), datë 7.7.2023, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 4687, datë 12.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të kësaj çështje. [...]”

9.1. Gjykata Administrative e Apelit arsyeton se (...)nga data e paraqitjes së padisë (13.6.2016) deri në marrjen e vendimit (7.7.2023), ka hyrë në fuqi ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili solli një ndryshim thelbësor në kuadrin ligjor. Ky ligj përcakton procedurat dhe organet përgjegjëse për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, për regjistrimin e titujve të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe për inventarizimin, transferimin, trajtimin dhe regjistrimin e tyre përfundimtar (neni 1). Qëllimi i ligjit është: i. krijimi i një baze të unifikuar ligjore për mbylljen e proceseve kalimtare; ii. koordinimi i tyre me procesin e trajtimit dhe kompensimit të pronës; iii. standardizimi i dokumentacionit për regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme (neni 2). Ligji parashikon një normim të posaçëm procedural edhe për çështjet gjyqësore të iniciuara



nga prefektët përpara hyrjes së tij në fuqi, të cilat vijonin ende gjykimin.

9.2. Neni 68/4 i ligjit nr. 20/2020 parashikon: “Paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të ligjit, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, shqyrtohen nga gjykatat sipas kritereve të këtij ligji. Ndërsa pika 5 i këtij ligji parashikon: “5. ASHK-ja heq dorë nga padia në të gjitha gjykimet në proces, përpara hyrjes në fuqi të ligjit, përveç rasteve kur shkaku ligjor është ai i përcaktuar në nenin 7/1 të këtij ligji.” Ky normim vjen si normim i posaçëm në raport me rregullimin e përgjithshëm juridik të kohës që kërkonte shqyrtimi nga KVVTP-ja pranë prefekturave, konform dispozitave të ligjit nr. 9948/2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ndryshuar, në raport me dispozitat e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë e për zbatim të e tyre.

9.3. Sipas nenit 68/5, mbi ASHK-në rëndon detyrimi ligjor për të hequr dorë nga padia, përveç rasteve të parashikuara në nenin 7/1. Ky nen parashikon përjashtimisht regjistrimin e AMTP-së të paregjistruara, kur plotësohen njëkohësisht tri kushte: a) përfituesi AMTP ka qenë i legjitimuar për të përfutuar tokë, sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe nëse nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfutuar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; b) përfituesi i AMTP-së ka marrë tokë në territorin e vetëm një ish-kooperativë ose ish-ndërmarrjeje bujqësore; c) toka për cilën është lëshuar AMTP nuk ka qenë “truall”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohën e lëshimit të aktit”. Pra ky nen normon sipas parashikimeve të tij procesin e regjistrimit dhe raportin juridik të ASHK-së me regjistrimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, të përfutuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Vetëm këto raste përjashtohen nga detyrimi ligjor i ASHK-së për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes.

9.4. Në rastin konkret nuk jemi përpara kushteve të nenit 7/1, pasi AMTP-ja nr. 461/1992, lëshuar në emër të Nazmi Beqirit, ka rezultuar **e regjistruar** në ZVRPP, që në kohën e hetimit administrativ nga prefekti i Qarkut Tiranë. ZVRPP Tiranë ka

konfirmuar regjistrimin e parcelës në emër të Nazmi Beqirit: pasuria nr. 205/15, vol. 16, f. 16, sipërfaqja 2600 m² “arë”. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 68/5 të ligjit nr. 20/2020, pala paditëse duhej të kishte kërkuar pushimin e gjykimit. Kjo për faktin se çështja është regjistruar për shqyrtim gjyqësor në vitin 2016, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, i cili tashmë është i zbatueshëm edhe për proceset gjyqësore në vijim. Kjo çështje vijon ende gjykimin e saj tashmë në shkallë të dytë kohë në të cilën ka hyrë në fuqi dhe gjen zbatim ligji nr. 20/2020.

9.5. Fakti se pala paditëse nuk ka disponuar me heqjen dorë nga ky gjykim nuk ndryshon gjendjen juridike në fuqi dhe as gjendjen faktike në të cilën ndodhet kjo mosmarrëveshje administrative, për shkak të ligjit në fuqi. Në rastin konkret Gjykata Administrative Apelit konkludon se pavarësisht faktit se ASHK Tiranë Rurale 2 nuk hoqi dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, ajo nuk mund të vijojë më tej për shkak të ligjit. Gjykata arrin në këtë konkludim pasi mban parasysh nenin 299 të KPC-së, i cili gjen zbatim në respektim të nenit 1/2 të ligjit nr. 49/2012. Përkatesisht në këtë nen parashikohet: “c) gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhdojë. Kur këto shkaqe konstatohen nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit”. Në respektim të kësaj dispozite gjykata konkludon se gjykimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje nuk mund të vijojë edhe pse pala paditëse nuk hoqi dorë nga gjykimi. Pasi pala paditëse në këtë gjykim, për shkak të ligjit nr. 20/2020, duhej të hiqte dorë nga gjykimi. Ky detyrim është i ardhur drejtpërdrejt mbi palën paditëse nga ligji. Në çdo rast mbahet parasysh se palë paditëse ka qenë dhe është për shkak të ligjit një organ publik, i cili në çdo rast duhet të ngrejë një padi, e cila të identifikojë një interes të ligjshëm për ngritjen apo gjykimin e mëtejshëm të saj. Nuk ka asnjë sens juridik që një organ publik që udhëhiqet në veprimtarinë e tij publike nga parimi i ligjshmërisë të prezumohet se ka një interes të ligjshëm, kur ky interes hiqet tashmë me një dispozitë ligjore. Kjo çështje tashmë pikërisht në zbatim të ligjit nr. 20/2020 nuk mbart më një interes të ligjshëm aktual prezent për vijimin e gjykimit të saj. Vetë ligji nr. 20/2020 ndërpret interesin e ligjshëm të palës paditëse ASHK përkundrejt kësaj çështjeje.



9.6. Fakti që ASHK-ja nuk ka hequr dorë nga padia nuk mund të sjellë zbatim të pabarabartë të të njëjtit kuadër ligjor në raste të ngjashme. Heqja dorë nga gjykimi, në këtë çështje, nuk është çështje diskrecioni e palës paditëse, në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 49/2012, por detyrim ligjor. Interesi i ligjshëm i një organi publik buron vetëm nga ligji; ekzistenca dhe kufijtë e këtij interesi përcaktohen ekskluzivisht prej tij. Kur vetë ligji parashikon se ASHK-ja duhet të heqë dorë, kjo vjen sepse ligji i ka hequr kësaj pale interesin e ligjshëm aktual për vijimin e gjykimit. Kjo gjendje e re juridike, e pavarur nga vullneti i palëve, prodhon të njëjtin efekt: procesi nuk mund të vazhdojë për shkak të ligjit. Aktualisht, pala paditëse nuk ka më lidhje juridike të vlefshme me padinë objekt gjykimi dhe, si pasojë, përmes këtij procesi nuk mund të realizohet asnjë interes i ligjshëm e as të krijohet një situatë juridike me bazë ligjore. Ligji nr. 20/2020 e ndërpret këtë lidhje dhe, për më tepër, e detyron ASHK-në të heqë dorë nga gjykimi në fazën ku ndodhet çështja.

9.7. Në përfundim, duke zbatuar nenin 299 të KPC-së, kjo gjykatë ka çmuar se gjykimi i çështjes duhet **të pushohet**. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 4687/2016 duhet **të prishet** dhe çështja të mbyllet, për shkak të humbjes së interesit të ligjshëm nga pala paditëse pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020.

10. **Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka paraqitur *rekurs të veçantë*, Avokatura e Shtetit, më datë 1.11.2023.** Me anë të rekursit kërkohet ndryshimi i vendimit dhe pranimi i padisë, *duke parashtruar si shkaqe, në mënyrë të përmbledhur:*

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë në kundërshtim me ligjin. Kjo gjykatë ka gabuar si në zbatimin e normave të së drejtës materiale (*errores in iudicando*), ashtu edhe në zbatimin e normave të së drejtës procedurale (*errores in procedendo*). Këto gabime, të cilat kanë karakter thelbësor, cenojnë parimin e ligjshmërisë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në njësimin, sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

- Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin e saj, nuk ka marrë në shqyrtim të plotë dhe të argumentuar pretendimet e palës paditëse të parashtruara nëpërmjet mjetit procedural të ankimit. Ky qëndrim, lidhur me zbatueshmërinë e ligjit nr. 20/2020, nuk është i drejtë, pasi padia është

paraqitur për gjykim në vitin 2016, në një kohë kur ky ligj ende nuk kishte hyrë në fuqi. Për më tepër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka gjykuar dhe ka vendosur në përputhje me kuadrin ligjor që ishte në fuqi në momentin e paraqitjes së padisë.

- Nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë rezulton se është mjaftuar vetëm me citimin e disa dispozitave të ligjit nr. 20/2020, konkretisht të neneve 7, 9 dhe 68 të tij, pa bërë një analizë të plotë të zbatueshmërisë së këtyre dispozitave në raport me kohën e paraqitjes së padisë dhe kuadrin ligjor në fuqi në atë periudhë. Në këtë kuptim, gjykata ka tejkalluar shkakun ligjor të padisë, duke vepruar në kundërshtim me parimet e përcaktuara nga jurisprudenca njëesuese e Gjykatës së Lartë.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, është shfuqizuar ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, i ndryshuar, i cili rregullonte veprimtarinë e komisioneve vendore për vlerësimin e titujve të pronësisë, nën varësi të prefektit. Si pasojë e këtij shfuqizimi, tagri dhe përgjegjësia për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë nuk i takojnë më institucionit të prefektit. Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 20/2020, organi kompetent për zbatimin e këtij ligji është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, së bashku me drejtoritë e saj rajonale dhe vendore.

- Neni 5, pika 22 e ligjit citon: “Agjencia Shtetërore e Kadastrës është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, apo nëpërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.” (Neni 5, pika 2 të ligjit nr. 20/2020.) Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, Gjykata Administrative e Apelit në respektim të nenit 199/2 të KPC-së, ka kryer kalimin procedural të palës paditëse nga prefekti i Qarkut Tiranë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë. Ky akt është formalizuar dhe i është komunikuar palëve nga gjykata.

- Ligji nr. 20/2020 ka sjellë një rregullim të ri në lidhje me çështjet e pronësisë të fituar me aktet e marrjes së tokës në pronësi, duke ngarkuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si autoriteti



publik përgjegjës për zbatimin e tij. Ky ligj parashikon shprehimisht, se kompetenca e ASHK-së shtrihen mbi kërkesat për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi, të vlerësimit të vendimeve të ish-KVVTP-së për shfuqizimin plotësisht/pjesërisht të tyre, të procedurave për verifikimin e AMTP-së të paregjistruara dhe regjistrimit të tyre në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme. Këto rregullime janë vendosur me qëllim arritjen e objektivit të ligjit 20/20, që konsiston në krijimin e një baze ligjore të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private, duke përcaktuar ndër të tjera normat për regjistrimin e titujve të pronësisë, të dhënë sipas akteve ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundimin e procesit të inventarizimit të pronave të paluajtshme të shtetit, trajtimin e problemeve në lidhje me mbivendosjet e titujve mbi pasurinë e paluajtshme etj.

- Gjykimi Administrativ kryhet në respektim të nenit 17, pika 2, e ligjit nr. 49/2012, cili përcakton, se: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Dhe nenin 37/1, i cili përcakton: “Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ”.

- Përderisa zbatimi i ligjit procedural apo material për rastin konkret nuk lidhet me nevojën për rivlerësimin e fakteve apo provave, por me domosdoshmërinë një interpretimi të ndryshëm të ligjit mbi të njëjtin fakt në momentin e kryerjes së veprimit, rezulton se arsyetimi i përdorur nga Gjykata Administrative e Apelit, për zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 20/2020, është i gabuar. Zbatimi i ligjit procedural apo material, për rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo provave, por nga domosdoshmëria për interpretim të

ndryshëm të ligjit mbi të njëjtin fakt (shih vendimin nr. 00-2017-(143), datë 25.2.2022, i Gjykatës së Lartë).

- Në këtë proces duhet pasur parasysh, se konstatimi i gjykatës, sipas të cilit titulli i pronësisë në emër të paditësit nuk ka vlerë juridike, për shkak se ky konstatim nuk është ankimuar nga palët e paditura, ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar dhe si i tillë nuk mund t'i nënshtrohej më verifikimit të vlefshmërisë ligjore sipas ligjit nr. 20/2020.

- Duke u mbështetur në vendimin njëses, në faktin që gjykata e shkallës së parë ka konkluduar për pavlefshmërinë e AMTP-së, konkluzion, i cili, për shkak se nuk është ngritur në ankim nga pala e paditur ka marrë vlerën e gjësë së gjykuar, si dhe në faktin se ASHK-ja nuk ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga padia, Gjykata Administrative e Apelit duhej të kishte pranuar ankimin si të bazuar ligj dhe të kishte vendosur në përputhje me kërkimet e parashtruara në të.

11. Me vendim të gjyqtarit të vetëm nr. 16436 (31025-06043-86-2016), datë 6.11.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur “Pranimin e rekursit”. Janë kryer njoftimet përkatëse dhe nuk rezulton të jetë depozituar kundërrekurs prej palëve të paditura.

12. Fashikulli gjyqësor dhe aktet procedurale janë regjistruar në Gjykatë të Lartë për kompetencë shqyrtimi, më datë 9.1.2024.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

- Mbi procedurën për njësimin e praktikës gjyqësore

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”) me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, më datë 5.2.2024 kreu veprimtarinë seleksionuese.² Më pas u krye planifikimi për shqyrtim në dhomë këshillimi, në kushtet kur çështja i përket kategorisë prioritare, pasi objekt i rekursit është vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, që ka disponuar për prishje të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit.

14. Prej shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, më datë 23.7.2024, Kolegji mori vendimin e ndërmjetëm, në zbatim të nenit 62/a, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) për nisjen e

² Për më shumë shih vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.4.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore në gjykimin administrativ, duke kaluar në seancë gjyqësore shqyrtimin e kësaj çështjeje.³ Kolegji shtroi për njësim pyetjen:

- Si gjen zbatim neni 68, pika 4, 5 e në vijim të kësaj dispozite kalimtare të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, për çështjet e regjistruara për shqyrtim pranë Gjykatave Administrative?

15. Pas zhvillimit të seancave gjyqësore, Kolegji, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, më datë 18.2.2025 shpalli vendimin përfundimtar, ku u përcaktua rregulli njësuës për praktikën gjyqësore dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes.

- Përcaktimi i rregullit njësuës për praktikën gjyqësore

16. Kolegji vlerëson se, për qëllime të njësimi të praktikës gjyqësore, interpretimi dhe zbatimi i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, është vendimtar për përcaktimin e legjitimitetit material aktiv të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në proceset e trashëguara nga institucioni i Prefektit të Qarkut, të ngritura mbi bazën e ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

17. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, që shënoi bazën e reformës agrare, përcaktoi ndarjen e tokës bujqësore sipas normës për frymë dhe krijimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP). Mungesa e një sistemi të njësuar administrativ dhe kontrollues solli, me kalimin e viteve, pasiguri mbi vlefshmërinë e titujve dhe konflikte në praktikën gjyqësore. Për t'i adresuar këto problematika, ligji nr. 9948/2008 vendosi mekanizmin e verifikimit të AMTP-së përmes komisioneve vendore nën mbikëqyrjen e Prefektit të Qarkut, të cilit iu njoh kompetenca për të paraqitur në gjykatë padi për pavlefshmërinë e titujve të lëshuar në kundërshtim me ligjin.

18. Ligji nr. 20/2020, i cili përmbyll këtë proces ligjor, u miratua për të garantuar sigurinë juridike të titujve të pronësisë dhe për të unifikuar përgjegjësinë administrative mbi regjistrimin dhe verifikimin e tyre, duke i kaluar kompetencat nga prefekturat tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës si organ unik

përgjegjës. Ky ligj, i miratuar edhe pas orientimit të dhënë nga Komisioni i Venecias, synon konsolidimin përfundimtar të marrëdhënieve juridike të pronësisë dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë.

19. Objekti i ligjit nr. 20/2020 (nenet 1 dhe 2), është përcaktimi i procedurave dhe organit shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore e private, si dhe për inventarizimin, transferimin, trajtimin dhe regjistrimin e tyre përfundimtar. Neni 5, pika 2, përcakton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve me institucionet e tjera qendrore dhe vendore.

20. Me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, rëndësi të veçantë në këtë kuadër ka neni 68 i ligjit, i cili përcakton pasojat e hyrjes në fuqi të tij mbi procedurat ekzistuese. Ky nen sanksionon se procedimet administrative pranë prefektit për verifikimin e titujve të pronësisë konsiderohen të pushuara; paditë e ngritura nga prefekti para hyrjes në fuqi të ligjit shqyrtohen sipas kriterëve të tij; ndërsa ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga paditë në proces, përveç rasteve kur shkaku ligjor i tyre bazohet në nenin 7, pika 1, të po këtij ligji.

21. Kolegji vlerëson se, përmes këtyre parashikimeve, ligji nr. 20/2020 ka **karakter ndërkohor**, pasi rregullon jo vetëm mënyrën e trajtimit të proceseve të reja, por edhe **vazhdimësinë dhe përfundimin e çështjeve gjyqësore në zhvillim**, të ngritura mbi bazën e legjislacionit të mëparshëm. Dispozita kyçe për këtë qëllim është neni 68, i cili përmban normat kalimtare që përcaktojnë se si duhet të trajtohen çështjet administrative që kanë filluar më parë. Në këtë kuptim, neni 68, pika 4 parashikon: “*Paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, shqyrtohen nga gjykatat sipas kriterëve të këtij ligji.*” Ndërsa pika 5 vijon: “*ASHK-ja heq dorë nga padia në të gjitha gjykimet në proces përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur shkaku ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.*”

³ Vendimi i ndërmjetëm mbi nisjen e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore administrative, ku jepen arsyet për nevojën e

njësimi është njoftuar me anë të publikimit në faqen zyrtare në web të Gjykatës së Lartë, siç përmendet dhe më lart.



22. Neni 68, pika 4 ka efekt të menjëhershëm, duke i detyruar gjykatat që edhe për paditë e nisura para hyrjes në fuqi të ligjit të zbatojnë kriteret materiale dhe procedurale të ligjit të ri. Kjo dispozitë përfaqëson një rregull ndërkohor, që unifikon standardet e shqyrtimit për çështjet në gjykim e sipër, duke reduktuar vëllimin e legjitimitit material të paditësit, për shkak të vlerësimit nga ligjvënësi, se jo çdo lloj shkelje ligjore në procesin e lëshimit të AMTP-së do të vlejë të ndiqet gjyqësisht nga ASHK-ja (duke u lidhur ky rregullim vetëm dhe ekskluzivisht me këto lloj padish, ku palë paditëse është ASHK). Për rrjedhojë, gjykata duhet të riorientojë kuadrin ligjor të vlerësimit të padisë (*petitum dhe causa petendi*) sipas ligjit nr. 20/2020, duke hetuar nëse akti i pronësisë i kontestuar bie brenda kufijve të nenit 7/1, i parë në harmoni me dispozitat e tjera të këtij ligji dhe, për rrjedhojë, nëse ekziston interes publik për vijimin e gjykimit.

23. Në plan praktik, neni 68, pika 4, i ngarkon gjykatës detyrimin të verifikojë nëse shkaqet e padisë së paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020 përputhen me shkaqet e padisë për të cilat ky ligj autorizon organet shtetërore për t'iu drejtuar gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e AMTP-së përkatëse dhe kalimin e pasurisë në pronësi shtetërore. Nëse këto shkaqe përputhen me ndonjërin nga shkaqet për të cilat ky ligj autorizon ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e AMTP-së (neni 8, pika 3, neni 9, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 20/2020), gjykimi vijon në themel sipas standardeve të ligjit të ri; në të kundërt, në mungesë të tyre, interesi publik për vijimin e procesit konsiderohet i shuar dhe padia duhet të rrëzohet për mungesë legjitimiti aktiv të paditësit. Përmes këtij qëndrimi, ligjvënësi ka vendosur që, pavarësisht kohës së shqyrtimit, të trajtojë në mënyrë të njëjtë subjekte, të cilat ndodhen në të njëjtat kushte. Kjo dispozitë duhet parë në bashkëveprim me nenin 68, pika 5, ku e para përcakton mënyrën se si gjykatat duhet të shqyrtojnë çështjet e nisura më parë, ndërsa e dyta sanksionon detyrimin *ex lege* të organit administrativ për të hequr dorë nga e drejta e padisë, duke e shndërruar këtë nga një akt diskrecionar në një pasojë të detyrueshme ligjore, që buron nga mungesa e interesit publik, për shkak të parashikimeve të shprehura ligjore.

24. Kolegji vlerëson se neni 68, pika 5, i ligjit nr. 20/2020, ka natyrë të posaçme dhe shpreh qartësisht vullnetin e ligjvënësit për të përmbyllur

procesin shumëvjeçar të verifikimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, sipas ligjit të mëparshëm. Qëllimi i tij është mbyllja përfundimtare e fazës kalimtare të konsolidimit të pronësisë dhe eliminimi i disa padive të caktuara që kanë mbajtur pezull për shumë kohë sigurinë juridike të titujve të lëshuar në bazë të ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve pasuese. Me këtë dispozitë, ligjvënësi ka synuar t'i japë fund ndërhyrjeve të vazhdueshme të administratës mbi disa kategori titujsh dhe të orientojë sistemin drejt një regjimi të njësuar pronësie, nën përgjegjësinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

25. Ky ligj, përveçse synon të krijojë siguri juridike në çështjet e pronësisë së tokës bujqësore përmes mbylljes përfundimtare të disa proceseve gjyqësore, nuk lë pa mbrojtje interesin publik, për mbrojtjen e të cilit paditë e ngritura para hyrjes së në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë të gjykojnë, apo nëse nuk janë ngritur akoma do të mund të ngrihen. Ligjvënësi e ka identifikuar në ligj interesin publik dhe ka lidhur me të vazhdimin apo fillimin e procesit gjyqësor.

26. Dispozita e nenit 68, pika 5 duhet të interpretohet në lidhje me nenin 7, pika 1, i cili përcakton vëllimin e legjitimitit aktiv të paditësit në mbrojtje të interesit publik. Edhe pse neni 7, pika 1 i referohet tekstualisht "AMTP-ve të paregjistruara", në të gjen pasqyrim edhe rasti kur mbrojtja e interesit publik legjitimon organet shtetërore për të kundërshtuar AMTP-të e regjistruara tashmë në regjistrat publikë (rasti i parashikuar në nenin 9, pika 2 në lidhje me nenin 7, pika 1 shkronja "c"), çka përbën një standard material të ligjshmërisë që vlen për çdo titull pronësie, të regjistruar apo të paregjistruar. Këto standarde përbëjnë treguesin e vetëm ligjor që përcakton nëse ekziston apo jo interes publik për vijimin e procesit gjyqësor dhe duhet të mbahen parasysh, si nga ASHK-ja edhe nga gjykatat në vlerësimin e ecurisë së gjykimit të padive të ngritura nga prefektët.

27. Në këtë kuadër, shtrohet çështja nëse efekti i nenit 68, pika 5 duhet lexuar edhe në dritën e nenit 9 të ligjit nr. 20/2020, i cili rregullon AMTP-të e regjistruara. **Neni 9, duke iu referuar shprehimisht kufizimit të parashikuar në nenin 7, pika 1, shkronja "c", përcakton se për titujt e regjistruar zbatohet i njëjti ndalim material lidhur me tokat me karakter publik.** Prandaj, megjithëse neni 7, pika 1 adreson titujt e



paregjistruar, lidhja që vendos neni 9 me shkronjën “c” tregon se ligjvënësi ka synuar që neni 68, pika 5, të veprojë edhe për AMTP-të e regjistruara, sa herë konstatohet ky kufizim material. Si rrjedhojë, detyrimi për heqje dorë ose rrëzimi i padisë për mungesë legjitimitimi aktiv vepron njëloj për të dyja kategoritë e titujve, duke ruajtur kriterin njësuës të nenit 7, pika 1, shkronja “c”.

28. Përcaktimi nëse vepron heqja dorë nga e drejta e padisë, sipas nenit 68, pika 5, kushtëzohet nga teksti material i nenit 7, pika 1, shkronja “c”, i cili i referohet karakterit publik të tokës (“truall”, “vepër infrastrukture publike”, “rërë bregdetare”, “plazh”, “sipërfaqe ujore”). Këto standarde materiale të vlefshmërisë së titullit, në përputhje me interpretimin e nenit 9, vlejnë njëloj si për AMTP-të e paregjistruara, ashtu edhe për ato të regjistruara. Nëse nga verifikimi gjyqësor nuk rezulton shkelje e këtyre kushteve, interesi publik për vijimin e gjykimit konsiderohet i shuar dhe vepron neni 68, pika 5, që sjell heqjen dorë nga e drejta e padisë ose rrëzimin e padisë për mungesë legjitimitimi aktiv. Vetëm në rastet kur konstatohet shkelje materiale sipas nenit 7, pika 1 (veçanërisht shkronja “c”), gjykimi vijon në themel si përjashtim i kufizuar që ruan interesin publik të ligjshëm dhe qëllimin e ligjit për mbrojtjen e tokës me karakter publik.

29. Në këtë mënyrë, qëllimi teleologjik i nenit 68, pika 5, është të vendosë një vijë ndarëse midis së kaluarës dhe së tashmes: të gjitha paditë e nisura nga prefekti i Qarkut dhe të trashëguara nga ASHK-ja duhet të ndërpriten, përveç rasteve të veçanta që përmbushin shkaqet materiale të nenit 7, pika 1, shkronja “c”. Ky rregull është instrumenti përmes të cilit ligjvënësi mbyll procesin kalimtar të pronësisë dhe përforcon sigurinë juridike të titujve të regjistruar, duke reduktuar ndërhyrjen shtetërore vetëm në rastet e abuzimit të qartë material. Në këtë mënyrë, heqja dorë nga padia nuk është më akt formal i vullnetit të administratës, por pasojë e detyrueshme e mbylljes së një procesi historik, që ligji e konsideron të përfunduar.

30. Kolegji çmon se ky synim i mbylljes përfundimtare të fazës kalimtare shpjegon pse ligjvënësi e ka lidhur vijimin e gjykimit vetëm me shkaqet materiale të nenit 7, pika 1, shkronja “c”, duke mos lejuar vazhdim padish kur ky test nuk rezulton i cenuar. Kufizimi material i parashikuar nga neni 7, pika 1, i lexuar në harmoni me nenin 9, reflekton drejtpërdrejt në legjitimitimin aktiv të

ASHK-së për paditë e trashëguara, pavarësisht statusit të regjistrimit të titullit.

31. Duke zëvendësuar prefektin me ASHK-në si palë paditëse, ligji nr. 20/2020 ka kufizuar legjitimitimin aktiv material të organit publik: ASHK-ja nuk ka më tagër të përgjithshëm për të vijuar çdo padi të nisur nga prefekti, por vetëm ato që mbështeten në shkaqet e nenit 7, pika 1, shkronja “c”. Ky legjitimitim është i derivuar *ex lege* dhe varet nga ekzistenca e një interesi të ligjshëm publik. Për pasojë, gjykata duhet të verifikojë jo vetëm formën e padisë, por edhe bazën ligjore që justifikon vijimin e saj, duke interpretuar nenet 68, pikat 4 dhe 5, në dritën e nenit 7, pika 1, shkronja “c”. Vetëm kur kjo bazë rezulton e plotësuar, vijon gjykimi në themel; në çdo rast tjetër, detyrimi për mbylljen e procesit rrjedh drejtpërdrejt nga ligji.

32. Neni 68, pika 5, i ligjit nr. 20/2020, që detyron ASHK-në të heqë dorë nga padia për të gjitha gjykimet në proces, përveç rasteve të nenit 7, pika 1, krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet interesit publik dhe detyrimit ligjor të organit administrativ. Ndryshe nga rregullimi i mëparshëm, ku prefekti kishte hapësirë diskrecionare për të vlerësuar nëse duhej apo jo të vijonte procesin gjyqësor, tani ligji e shndërron këtë në **një detyrim ex lege**, që lind automatikisht nga mungesa e shkaqeve materiale të parashikuara në nenin 7, pika 1, veçanërisht shkronja “c”.

33. Ky detyrim nuk ka karakter formal, por përbën **pasojë të mungesës së legjitimitimit aktiv material** që rezulton nga ndërhyrja e ligjit të ri. Në momentin që ligji i heq organit publik tagrin për të vijuar procesin për kategori të caktuara mosmarrëveshesh, ai humbet pozitën e palës së legjitimuar për qëllime gjyqësore, sepse i pakësohet me ligj legjitimitimi aktiv. Heqja dorë nga padia, në këtë kuptim, nuk është akt vullneti, por **pasojë deklarative e një efekti ligjor tashmë të krijuar**. Rrjedhimisht, në rastet kur ASHK-ja nuk ka depozituar një akt formal heqjeje dorë, gjykata kur nuk janë rastet përjashtimore të cituara më sipër, nuk mund të vazhdojë shqyrtimin e padisë sikur ky detyrim të mos ekzistonte, por duhet të **konstatojë mungesën e interesit publik dhe të legjitimitimit aktiv** dhe të vendosë rrëzimin e padisë. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e **parimit të ligjshmërisë**, sipas të cilit organet publike mund të veprojnë vetëm brenda kompetencave që u njeh ligji.



34. Në këtë drejtim, Kolegji thekson rëndësinë praktike të dallimit ndërmjet “pushimit të gjykimit” dhe “rrezimit të padisë”. Pushimi është pasojë e një **heqjeje dorë formale** të bërë nga pala, ndërsa rrezimi për mungesë legjitimimi aktiv është **pasojë ligjore**, që lind vetvetiu kur ligji ia ka hequr organit publik këtë të drejtë. Në rastet kur ASHK-ja nuk ka ushtruar aktin formal të heqjes dorë, por ligji ia ka ndaluar vijimin e procesit, gjykata duhet të **rrëzojë padinë** për mungesë interesi të ligjshëm. Duhet theksuar këtu, se heqja dorë për të cilën flet ligji nr. 20/2020, nuk lidhet me heqjen dorë nga gjykimi i padisë, sipas kuptimit të nenit 201 të KPC-së, por me atë të heqjes dorë nga e drejta e padisë, sipas nenit 201/a të KPC-së.

35. Ky interpretim siguron zbatimin e **parimit të sigurisë juridike**, duke shmangur mbajtjen e qytetarëve nën pasigurinë e proceseve të pafundme gjyqësore për tituj pronësie të fituar prej kohësh, për të cilat ligji i ka hequr tashmë legjitimitimin aktiv paditësit ASHK. Vetëm rastet e jashtëzakonshme, kur ekzistojnë shkelje të rënda materiale sipas nenit 7, pika 1, shkronja “c” justifikojnë vijimin më tej të procesit gjyqësor. Kjo qasje është në përputhje me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata zgjidh mosmarrëveshjet “në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi që janë të detyrueshme”. Për rrjedhojë, gjykatat janë të detyruara të zbatojnë kriteret dhe pasojat e përcaktuara nga ligji nr. 20/2020, i cili ka zëvendësuar plotësisht ligjin nr. 9948/2008 dhe ka vendosur standardin përfundimtar të shqyrtimit gjyqësor në këtë fushë.

36. Parimet e mësipërme praktikisht përcaktojnë: Nëse padia ngre shkaqe që bien nën kriteret materiale të nenit 7, pika 1, shkronja “c” gjykata vijon shqyrtimin në themel dhe vendos sipas fakteve të provuara; nëse jo, konstatohet mungesa e legjitimitimit aktiv material dhe padia rrëzohet. Ky standard vepron njëllësi si për AMTP-të e paregjistruara, ashtu edhe për AMTP-të e regjistruara, ku në mungesë shkeljeje sipas nenit 7, pika 1, shkronja “c” aktivizohet detyrimi i heqjes dorë sipas nenit 68, pika 5; kur heqja dorë nuk shprehet formalisht, pasoja është rrezimi për mungesë interesi të ligjshëm.

37. Pra, për paditë e ngritura nga prefekti përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, ASHK-ja ka detyrimin *ex lege* të heqë dorë, përveç rasteve të parashikuara nga neni 7, pika 1; në mungesë të

heqjes dorë, gjykata konstaton mungesë legjitimimi aktiv material të palës publike dhe rrëzon padinë.

38. Sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se legjitimimi aktiv material i ASHK-së në proceset e trashëguara nuk është i përgjithshëm, por i kufizuar nga ligji; zbatimi i ligjit nr. 20/2020 redukton qëllimisht hapësirën e ndërhyrjes publike, në funksion të përfundimit të proceseve kalimtare dhe stabilizimit përfundimtar të regjistrimeve.

39. Duke u mbështetur në këtë analizë të plotë dhe në interpretimin sistematik të ligjit nr. 20/2020, Kolegji çmon se duhet të përcaktohet në mënyrë përfundimtare rregulli njëses që do të drejtojë praktikën gjyqësore në të gjitha rastet analoge.

40. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në interpretim sistematik të neneve 7, pika 1, dhe 68, pika 4 e 5, të ligjit nr. 20/2020, Kolegji konkludon në këtë rregull njëses:

i. *Në zbatim të nenit 68, pika 5 të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, më datë 7.5.2020, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-së, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë, përveç rasteve kur shkaku ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.*

ii. *Kur mungon vullneti i shprehur për heqjen dorë nga e drejta e padisë prej ASHK-së, në zbatim të nenit 68, pika 4, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, gjykatat vijojnë shqyrtimin e padive të ngritura nga prefektët me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-së, sipas kriterëve të këtij ligji.*

iii. *Në rast se në padi ngrihen formalisht pretendime me shkaqe nga ato të përcaktuara nga neni 7, pika 1, të ligjit nr. 20/2020, gjykatat disponojnë për pranimin ose rrëzimin e padisë, varësisht gjendjes së faktit të vërtetuar. Nëse padia nuk ngre formalisht asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 7, pika 1 të ligjit nr. 20/2020, gjykatat vlerësojnë mungesën e legjitimitimit aktiv material të palës paditëse dhe disponojnë me rrëzimin e padisë.*

- Zgjidhja e çështjes konkrete.



41. Në vlerësim të fakteve të pranuar nga gjykatat më të ulëta, Kolegji konstaton se padia është ngritur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020 dhe, për rrjedhojë, mbi të veprojnë dispozitat kalimtare të nenit 68, pika 4 dhe 5 të këtij ligji. Në zbatim të këtyre dispozitave, ASHK-ja, si pasardhëse ligjore e prefektit, gëzon legjitimitim aktiv vetëm për rastet kur shkaqet e padisë përputhen me kriteret materiale të nenit 7, pika 1, shkronja “c”. Në mungesë të këtyre shkaqeve, interesi publik për vijimin e procesit gjyqësor shuhet dhe padia nuk mund të vazhdojë.

42. Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, sipas fakteve të konstatuara nga gjykata më e ulët nuk është provuar ndonjë nga shkeljet materiale të përcaktuara në nenin 7, pika 1, shkronja “c”. Për rrjedhojë, organi publik nuk ka më legjitimitim aktiv material për të ndjekur procesin. Heqja dorë nga padia në këtë rast nuk është çështje vullneti, por pasojë e drejtpërdrejtë e detyrimit ligjor të nenit 68, pika 5, që ndalon vijimin e proceseve të tilla.

43. Në këtë kuptim, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka pushuar gjykimin, është i pasaktë, pasi padia duhej të rrëzohej për mungesë legjitimitimi aktiv material, në përputhje me rregullin njësues dhe qëllimin e ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 1, pika 2, neni 58, në lidhje me nenin 62/a dhe neni 63, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49/2012, *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 494 (86-2023-720), datë 7.7.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe të vendimit nr. 4687 (80-2016-4727), datë 12.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

2. Ky vendim njësues botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 18.2.2025.

Kryesues: Sokol Sadushi

Anëtarë: Asim Voksi, Arbena Ahmeti, Enkelejda Metaliaj (Softa), Gentian Medja

KËRKESË

Shtetasja Llambrini Papa kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë shpalljen të zhdukur të vajzës së saj, Katerina Papa, më datë 26.12.2005, e datëlindjes 8.4.1987, lindur në Sarandë dhe banuese në Cukë, Sarandë.

KËRKUESE
Llambrini Papa

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

